



**Koalicioni i
Vëzhguesve
Vendorë**

Contact: *Tel/fax:* + 355 4 2245078; *Mob.* + 355(0)692469393; (0)682039297;
E-mail: info@zgjedhje.al; *Website:* www.zgjedhje.al;

ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

21 QERSHFOR 2015

**RAPORT I NDËRMJETËM
MONITORIMI III**

22 Maj – 18 Qershor 2015

Tiranë, më 19 Qershor 2015

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë falënderon:

- Programin e Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci pranë Ambasadës së SHBA-së në Tiranë,

- Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA) dhe

- Delegacionin e Bashkimit Europian (BE) në Tiranë për mbështetjen financiare të ofruar,

si edhe

- të gjithë aktivistët e të 33 organizatave të Koalicionit për kontributin e tyre vullnetar në realizimin e objektivave të monitorimit përgjatë periudhës që përfshihen në tre Raportet e Ndërmjetme të Monitorimit të publikuara deri tani.

Përmbajtja dhe opinionet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e vetme e KVV-së dhe nuk pasqyrojnë në asnjë rast edhe ato të donatorëve!

PËRMBAJTJA

	<i>Faqe</i>
I. Gjetje	5
II. Çështje të vërejtura dhe qendrimi i KVV-së	9
A. Mosrespektimi i ligjit dhe diskrecionaliteti në vendimarrje	9
B. Recidivizmi në administrimin e zgjedhjeve	10
C. Rasti i kandidatit të APPD në Bashkinë e Kurbinit	13
D. Rasti i kandidatit të APPD në Bashkinë e Këlcyrës	17
E. Rasti i i kandidatit të pavarur në Bashkinë e Memaliajt	19
F. Listat e zgjedhësve	20
III. Të dhëna të konstatuara	24
A. Administrimi i zgjedhjeve	24
A.1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	24
A.2. Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor	24
A.3. Komisionet e Qendrave të Votimit	26
A.4. Vendet dhe Grupet e Numërimit të Votave	27
B. Fushata zgjedhore	28
C. Media	31
D. Pjesëmarrja e grave	34
E. E drejta për informim dhe vëzhguesit	35
IV. Rekomandime	39
V. Aksioni i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë	41
VI. Fjalorth	41

I. GJETJE

Vullneti politik për bashkëpunim e dialog ka vazhduar të mungojë, e dukshme kjo qoftë në tentativat e dështuara për dekriminalizimin e politikës, shoqëruar me akuza e kundërakuza të ndërsjellta për bllokim e mungesë vullneti nga kundërshtari politik, qoftë në mungesën e vullnetit të shumë kandidatëve për kryetarë bashkie të përballen me njëri-tjetrin në takime elektorale, duke e realizuar fushatën, në rastin më të mirë në injorim të kandidatëve kundërshtarë dhe në rastin më të keq në mesazhe publike denigruese ndaj tyre.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve megjithë vështirësitë kohore të përcaktuara nga shkelja e afateve të një sërë procesesh përgatitore, ka arritur të menaxhojë mirë përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore për ditën e zgjedhjeve.

Gjithashtu është për t'u vlerësuar roli i tij aktiv në fushatën për edukimin e shtetasve rreth rëndësisë së votës e veçanërisht ndaj kategorive të marginalizuara, votuesve me aftësi të kufizuara, minoriteteve, etj.

Në procesin e ankimimeve të trajtuara si pjesë e drejtësisë zgjedhore, vihet re se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka një vendimmarrje inkohërente, diskrecionale, duke shkelur madje edhe parimin e prezumimit të pafajësisë, duke krijuar kështu precedent negativ të rezikshëm për ecurinë e mëtejshme të procesit.

Madje dalja e saj nga tagrat e vet ligjor në disa raste, e shfaq atë si burim të së drejtës zgjedhore.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve megjithë përmirësimet e ndjeshme në performancën e saj, në disa raste paraqitet e pasaktë dhe jo në lartësinë e duhur, duke përgatitur dhe publikuar ndër të tjera akte me gabime drejtshkrimore e materiale, si dhe përgjatë punës përgatitore në caktimin e QV-ve dhe VNV-ve.

Aktorët zgjedhorë (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, administrata e KQZ-së, subjektet politike parlamentare), ndonëse janë përballur me problematika të ngjashme në zgjedhjet pararendëse, si caktimi i QV-ve dhe i VNV-ve, nuk morën asnjë iniciativë amenduese të kuadrit ligjor.

Problematika e shfaqur në caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit si edhe të vendeve të numërimit të votave përveç të tjerash ngarkon me përgjegjësi edhe Kryetarëve të Njësisve Vendore dhe Prefektët.

Retorika dhe qëndrimet politike rreth kandidatëve me rekorde penale si dhe mungesa e adresimeve të qarta në Kodin Zgjedhor lidhur me ç' regjistrimin e kandidatëve vendosi në stres në këtë periudhë vëzhgimi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Kolegjin Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor në çështjet e trajtuara edhe gjatë kësaj periudhe vazhdon të shfaqë tipare prej gjykate ligji, madje edhe ky institucion shfaqet si burim i së drejtës zgjedhore.

Vendimmarrja e Kolegjit Zgjedhor vazhdon të jetë inkohrente me veten.

Fushata zgjedhore u ndërtua kryesisht në formën e takimeve të ngushta me komunitetin nga ana e kandidatëve për kryetarë ndërkohë që mitingjet masive u rezervuan rezervuar për takimet elektorale në të cilat kanë qenë prezentë drejtuesit e partive kryesore të koalicioneve apo partive.

Edhe në këtë raund zgjedhor, pavarësisht se kemi të bëjmë me zgjedhje për pushtetin vendor, fushata vuajti nga protagonizmi i kandidatëve për kryetar bashkie apo drejtuesve të partive duke lënë në hije kandidatët për këshillin bashkiak.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar marketingut elektoral të kushtueshëm në formën e reklamave të vendosura në rrugë, flamurëve e banderolave në shtyllat e ndriçimit, shpërndarjes së fletëpalosjeve derë më derë dhe reklamës në mediat elektronike, përfshi mediat sociale. Programet e ofertat konkrete, të artikuluar e arsyetuara bindshëm kanë munguar.

Premtimet elektorale kanë qenë të fokusuar kryesisht në investime infrastrukturore por ka munguar argumentimi dhe hapat konkretë për gjetjen e burimeve financiare për realizimin e tyre. Kandidatët e Aleancës për Shqipërinë Europiane e kanë argumentuar gjetjen e fondeve të nevojshme, përgjithësisht në financimet nga qeveria.

Përdorimi i fëmijëve në takimet elektorale, veshur me simbole të partive garuese apo mbajtur pankarta elektorale është vënë re edhe në këtë fushatë.

Gjatë fushatës nuk kanë munguar incidentet, të cilat janë pasqyruar gjerësisht nga media, ndërkohë që kandidatët dhe partitë politike kanë munguar të distancohen nga incidentet në të cilat janë bërë protagonistë mbështetësit respektivë, duke tentuar përgjithësisht drejt justifikimit të tyre si të provokuara nga kundërshtarët politikë.

Pretendimet për blerje vote kanë qenë prezente dhe publikuar në media. Në shumicën e rasteve tentativat për blerje të votës kanë qenë nëpërmjet shpërndarjes së ndihmave ushqimore për familjet në nevojë.

Media e ka transmetuar gjerësisht fushatën zgjedhore duke vazhduar transmetimin e takimeve elektorale me sinjal, kasete dhe tekst të prodhuar nga shtabet elektorale të partive politike.

Gjatë fushatës zgjedhore administrata është angazhuar gjerësisht, shpesh gjatë orarit zyrtar të punës. Shfaqja publike e ministrave të qeverisë apo të tjerë zyrtarëve të lartë qeveritarë në krah të kandidatëve për kryetarë bashkie ka qenë e zakonshme.

Bordi i Monitorimit të Medias ka zhvilluar aktivitetin e vet duke gjykuar në pozita të ndara sipas linjave partiake.

Në dy prej tri raporteve të paraqitura nga BMM opinionet e shumicës dhe pakicës kanë qenë të ndara në lidhje me sanksionet që duhet të vendoseshin ndaj mediave pavarësisht dakordësisë në lidhje me minutazhin e paraqitur në raporte.

Mungesa e transparencës në përzgjedhjen e anëtarëve të BMM prej anëtarëve të KQZ shpuri në një situatë ku ndasia politike zotëruese në vend u reflektua deri tek BMM.

Gjatë tri javëve të para të fushatës mediat kanë patur disbalancë në transmetimin e aktiviteteve elektorale të partive të ndryshme, disbalancë e cila u përmirësua në javën e fundit, sipas raportit të datës 15 qershor të BMM.

Gjuha e përdorur nga mediat tradicionale në vend gjatë fushatës zgjedhore ka qenë qenë përgjithësisht e balancuar, me përjashtime të pakta.

Kuota gjinore prej 30% u respektua në momentin e konstituimit të KZAZ-ve dhe u ruajt në vazhdim, edhe pas zëvendësimeve të shumta të anëtarëve të KZAZ-ve.

Pavarësisht arritjeve ligjore dhe ruajtjes së kuotave gjinore në KZAZ, ajo çka u vu re është se gjatë fushatës gratë kandidatë për këshillat bashkiakë nuk luajtën ndonjë rol. Fenomeni nuk është i shkëputur megjithatë, pasi kandidatët për këshillin bashkiak kanë qenë të padukshëm gjatë fushatës në përgjithësi duke qenë se fushata zgjedhore u fokusua vetëm në kandidatët për kryetarë bashkie.

Në të gjithë vendin, në përgjithësi ka patur një rritje të pjesëmarrjes së grave në takime elektorale, në krahasim me zgjedhjet e fundit.

KQZ është treguar e ngurtë ndaj kërkesave të vëzhguesve, duke mos ofruar informacionin e kërkuar ose duke e ofruar atë të mangët edhe në periudhën e mbuluar nga ky raport. Madje prej datës 15 qershor administrata e KQZ ka ndërprerë shpërndarjen e materialeve paraprake të mbledhjeve për vëzhguesit vendorë, duke e kufizuar ndjeshëm efikasitetin e vëzhgimit të mbledhjeve të KQZ-së.

Akoma më problematike bëhet kjo situatë duke qenë se materialet paraprake të mbledhjeve jo gjithnjë janë në faqen zyrtare të KQZ-së dhe shpesh shumë materiale mungojnë.

Zgjedhjet Lokale 2015 do të vëzhgohen nga 2673 vëzhgues vendas dhe të huaj, akredituar deri në datë 17 Qershor, Nga këta, 289 janë vëzhgues të akredituar nga organizata ndërkombëtare, 2212 janë akredituar nga organizata vendore, 53 nga përfaqësitë diplomatike në Shqipëri dhe 119 nga mediat.

Ndryshimi i anëtarëve të KZAZ-ve prej partive politike që i propozojnë ata, vazhdon të mbetet problem edhe në periudhën e mbuluar nga ky raport. Në total, gjatë kësaj periudhe janë ndryshuar 130 anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve (20,6% e totalit). Shqetësues vazhdon të mbetet funksionimi i KZAZ-ve jashtë orarit të përcaktuar. Në pothuajse asnjë rast ky orar nuk respektohet nga anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve.

Ka KZAZ në të cilat ende nuk është realizuar ngritja e KQV-ve, ndërsa në disa KZAZ ky proces është realizuar jashtë afateve ligjore.

Pjesëmarrja në trajnimet e zhvilluara për komisionerët e Qëndrave të Votimit, pjesëmarrja ka qenë e ulët. Nëse i shtojmë këtij fakti ndryshimin e shpeshtë të anëtarëve të KQV-ve, krijohet një shqetësim serioz përsa i përket mbarëvajtjes së procesit ditën e zgjedhjeve.

Përgjithësisht partitë politike i kanë çuar propozimet e tyre për anëtarë të GNV-ve, pranë KZAZ-ve përkatëse. Por në fare pak raste ka filluar trajnimi i tyre.

Procesi zgjedhor do të administrohet në ditën e zgjedhjeve nga 5299 Komisione të Qëndrave të Votimit (KQV), nga të cilat 4862 janë të vendosura në ambiente publike, 417 QV janë të vendosura në ambiente private me vendim të KQZ, dhe 20 QV janë të vendosura në institucione të posaçme.

II. ÇËSHTJE TË VËREJTURA DHE QENDRIMI I KVV-SË

A. MOSRESPEKTIMI I LIGJIT DHE DISKREACIONALITETI NË VENDIMMARRJE

Në ecurinë e deritanishme të procesit zgjedhor, institucioni ku është vërejtur më së shumti fenomeni i mosrespektimit të ligjit dhe diskreacionalitetit në vendimmarrje është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Në shumë raste kur përballen me një ngërç procedural, është vënë re në ligjërimet e aktorëve zgjedhorë (përfaqësuesit e partive politike, anëtarët e KQZ-së, administrata e KQZ-së), të argumentohet në frymën se *“ndonëse kuadri ligjor na e pamundëson, ne kemi detyrimin të zhvillojmë zgjedhje”*.

Kjo vihet re sidomos në rastet kur kuadri ligjor, pasi është shkëlur njëherë ose më shumë, ose kur vetë ka mangësi, krijon *“impasse”* në ecurinë e procesit zgjedhor.

Zhvillimi i zgjedhjeve periodike në përputhje me parimet e një demokracie kushtetuese është një përpjekje në të cilën shoqëria shqiptare është angazhuar prej 25 vitesh. Ashtu siç duhet përmendur që është një përpjekje që akoma vuan në arritjen e standarteve minimaliste.

Në logjikën shtetformuese, Kodi Zgjedhor është rregulluesi i tërë organizimit dhe i përgatitjes së zgjedhjeve.

Ky kuadër parashikon veçmas rregullave edhe institucionet ligjzbatuese (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve, Komisionet e Qendrave Votimit, Kolegji Zgjedhor).

Zhvillimi i një procesi zgjedhor korrekt dhe legjitim, përse u përmend, do të thotë zbatim besnik i tërë dispozitave të Kodit Zgjedhor.

Nëse në gjykimin e kujt do agjenti zgjedhor kuadri ligjor është i mangët ose i padrejtë (përkundrejt çdo parimi sado i rëndësishëm qoftë), nuk mund t'i japë vetes të drejtën t'a anashkalojë ose të sillet ndryshe nga rregullimi që bën ligji. Ky ëshë mësimi më bazik i jurisprudencës.

Tërë agjentët zgjedhorë në frymën *“ndonëse kuadri ligjor na e pamundëson, ne kemi detyrimin të zhvillojmë zgjedhje”*, që u përmend më sipër, kanë krijuar një traditë tepër negative në mbarëvajtjen e zgjedhjeve.

Edhe duke e marrë të mirëqenë vullnetin e tyre pozitiv (megjithëse duhet përmendur se në raste të ndryshme ka qenë thjesht një pretekst), përballë kësaj traditë të rrezikshme, qasja e tyre ka rezultuar tërësisht e dështuar.

Në fund të secilit proces zgjedhor, kanë rezultuar standarte jo të arrira dhe me kritika të forta nga palët humbëse.

Nëse në zgjedhjet e vitit 2013, Kolegji Zgjedhor e dubloi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në funksionet e tij më primare, këtë vit ky institucion po dublon Gjykatën Kushtetuese.

Në rastin e parë u argumentua si i vetmi bypass për të finalizuar zgjedhjet, ndërsa në rastin e dytë vjen si vetë censurim i Gjykatës Kushtetuese nga drejtësia zgjedhore me vendimin numër 53, datë 07.05.2013.

Këto dy sjellje po e denatyrojnë këtë gjykatë nga funksioni që i jep Kodi Zgjedhor, ai i një shkallë të dytë gjykimi zgjedhor.

Në këtë periudhë, Kolegji Zgjedhor me Vendimin numër 13, i dhuroi një tagër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që nuk ia jep kuadri ligjor. Bëhet fjalë për të drejtën e ç' regjistrimit të kandidaturave për Kryetar Bashkie.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nga ana tij shfaq dy profile në administrimin e zgjedhjeve.

Në njërin profil shihet të dalë nga tagrat e tij duke u investuar si organ hetimor, si në rastin kur shqyrtoi vlefshmërinë dhe origjinalitetin e nënshkrimeve për kandidatin e Partisë Socialdemokrate, z. Artur Topi. Gjithashtu, edhe në rastin e kandidatit të Partisë Demokratike, z. Gentian Muhametaj, kur u investua në hetimin e pastërtisë penale të personit.

Përkundrejt këtij ekzagjerimi në tagra, po ky institucion, në rastin e regjistrimit të listës së kandidaturave nga Partia Konservatore, i drejtohet me shkresë KZAZ-së për regjistrim jashtë afatit ligjor.

Në këtë profil të dytë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shfaq një informalitet ligjor, jo vetëm të kundërt me rastet e sipërpërmendura, por edhe në kundërshtim me ligjin.

Në këtë periudhë në të cilën referohet raporti i vëzhgimit, fenomeni i moszbatimit të ligjit dhe diskrecionaliteti në vendimmarrje është shfaqur përgjatë tërë procesit.

Një fenomen i cili edhe në këto zgjedhje, nëse ndiqet ky drejtim, mund të bëhet një nga arsyet që do të në pikëpyetje ligjshmërinë e procesit.

B. RECIDIVIZMI NË ADMINISTRIMIN E ZGJEDHJEVE

1. Caktimi i vendodhjes së Qendrave të Votimit

Në organizimin e zgjedhjeve, përpos problematikave të reja, *vihen re edhe situata recidiviste*. Problematikë kjo e krijuar nga keqadministrimi, madje edhe nga paaftësia e administratës, duke krijuar kështu shkelje në afate. Më pas, këto tejkalime në afate rrezikojnë të prodhojnë artificialisht problematika të tjera njëra pas tjetrës.

Një shembull për këtë është caktimi i qendrave të votimit. Kodi Zgjedhor në nenin 62 pika 4 shprehet qartësisht si vijon: “...Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja.”

Kësaj dispozite i është referuar dhe është argumentuar shumë herë mbi përmbajtjen e saj, edhe në Zgjedhjet e Qershorit 2013.

Një dispozitë që rregullon dy çështje. Deri kur mund të ndryshohen vendndodhjet e qendrave të votimit dhe për cilën arsye ky afat mund të mos respektohet.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë ka qenë një prej aktorëve që e ka vlerësuar këtë dispozitë të mangët, megjithëse bie dakort me logjikën e legjislatorit. Caktimi i qendrave të votimit nuk mund të shtrihet në një afat të gjatë dhe në afërsi me datën e zgjedhjeve.

Praktika ka treguar se për arsye ndonëse jo madhore, por të konsiderueshme, në disa raste ka lindur nevoja për ndryshimin e vendodhjes së qendrave të votimit.

Duke lënë mënjanë këtë pranim të dritëshkurtësisë së kuadrit ligjor, duhen përmendur tre vërejtje.

a) *E para*, ka të bëjë me faktin që tërë aktorët zgjedhorë (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, subjektet politike parlamentare), ndonëse janë përballur me problematikën në fjalë në zgjedhjet pararendëse, nuk morën asnjë iniciativë amenduese të kuadrit ligjor. Një mosveprim që e risolli problematikën edhe në këto zgjedhje.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në vazhden e organizimit për Zgjedhjet Vendore të Qershorit 2015, ka marrë katër vendime për autoriziminin e ndryshimit të vendodhjes së qendrave të votimit:

- Vendimi numër 630, datë 10.06.2015;
- Vendimi numër 660, datë 16.06.2015;
- Vendimi numër 670, datë 17.06.2015;
- Vendimi i datës 18.06.2015.

Me Vendimin nr. 630 u ndryshuan vendndodhjet e 21 qendrave të votimit, me Vendimin nr. 660 u ndryshuan vendodhjet e 10 qendrave të votimit, me Vendimin nr. 670 u ndryshuan vendodhjet e 2 qendrave të votimit, dhe me vendimin e datës 18.05.2015 u ndryshuan vendodhjet e 11 qendrave të votimit. (Në total për periudhën e vëzhgimit, 34 qendra votimi)

Të katra këto vendimmarrje ishin në tejkalim të kufirit ligjor.

Kjo do të thotë që zgjedhësit e këtyre qendrave, për faj të keqadministrimit, më së paku do kenë më pak kohë për t'u vënë në dijeni se ku do të votojnë ditën e zgjedhjeve.

b) *Vërejtja e dytë* vjen për mospërbushjen e detyrave nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Kryetarëve të Njësisve Vendore në caktimin e vendndodhjes së qendrave të votimit. Në relacionet e administratës për autoriziminin e ndryshimeve të vendodhjeve të qendrave të votimit, ndër të tjera, gjejmë këto argumentime:

- pronari i qendrës private është larguar jashtë shtetit¹;
- godina publike e përcaktuar është në rikonstruksion²;
- ambjenti i përcaktuar është në kushte të papërshtatshme fizike³;
- ambjenti i përcaktuar përdoret edhe për qendra votimi të tjera duke rrezikur mbipopullim të këtyre ambjente gjatë ditës së zgjedhjeve⁴;

¹ QV 19591 (miratuar me Vendimin 81, datë 04.04.2015) ... *Arsyeja e këtij ndryshimi është se jemi informuar në rrugë informale se pronari i saj është larguar jashtë shtetit dhe nga verifikimi në terren rezulton i mbyllur me qepena.* (Njësia Bashkiake Nr. 9 me shkresë nr. 6119 prot, datë 15.06.2015)

² QV 2019 / QV 20191 ... *të kalojnë në ambient tjetër se ky kopsht është në rikonstruksion dhe kjo godinë nuk është funksionale.* (Drejtoria Arsimore Rajonale e qytetit Tiranë me shkresë nr 6083 prot, datë 15.06.2015)

QV 1995 / QV 1996 / QV 19961 / QV 1998 / QV 19981 / QV 1999 / QV 19991 ... *Shkolla e mesme e përgjithshme "Qemal Stafa" është në rikonstruksion.* (KZAZ nr. 40 Tiranë, me e-mail)

³ QV 0326 / QV 03261 ... *ambienti aktual Qendër Shëndetësore, Plazh Velipojë, për arsye se janë në gjendje të mjerueshme dhe funksionojnë si magazinë materiale të dala jashtë përdorimit* (Përfaqësuesi në KQZ i Partisë Demokratike, z. Ivi Kaso, me shkresë nr. 6108 prot, datë 15.06.2015)

⁴ QV 3048 / QV 30481 ... *për arsye se në ambientin Kinoklubi janë të vendosura edhe 2 QV të tjera (pra 4 QV) si dhe KZAZ 60, gjë që do të sjellë probleme gjatë procesit të votimit për shkak të fluksit të madh.*

- pronari i qendrës private nuk pranon më të japë me qera ambientin e rënë dakort, etj.

Shkaqet e përmendura, jo vetëm që nuk mund t'i përafrohen forcës madhore, që është kushti i vetëm i përcaktuar dhe që kërkon Kodi Zgjedhor, por janë arsye plotësisht të mjaftueshme për të mos i konsideruar fare këto vendndodhje për qendra votimi që në fillim të procesit të caktimit të vendndodhjeve të QV-ve.

Për këtë mosfunksionim në caktimin e vendodhjeve të qendrave të votimit, përgjegjësia bie mbi Kryetarët e Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) dhe administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

c). *Pasaktësitë në organizimin e punës në ngritjen e Komisioneve të Qendrave të Votimit* bëhen serioze në Vendimin numër 629⁵, datë 10.06.2015, i cili shton një qendër votimi për zgjedhjet e 21 Qershorit, të “harruar” në vendimmarrjen e mëparshme.

Me Vendim nr. 446, datë 19.05.2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi sasinë e fletëve të votimit që do të prodhoheshin për çdo Qendër Votimi. Nga të dhënat e marra më pas prej Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor, sipas listave përfundimtare që kishin dërguar pranë tyre Kryetarët e Njësive të Qeverisjes Vendore, rezultoi se në Bashkinë Dibër kishte mbetur një qendër votimi pa u përfshirë.

Konkretisht bëhej fjalë për Qendrën e Votimit nr. 1135/1, me 813 zgjedhës.

Lënia pa përfshirë e një qendre votimi dhe përfshirja e saj në tejkallim të afatit, janë shfaqje të paaftësisë që krijon shkelje afati, dhe më pas është shkelja e afatit që sjell pasojat në cilësinë e administrimit të procesit.

2. Caktimi i vendndodhjes së Vendeve të Numërimit të Votave

Një tjetër shembull i situatave recidiviste është dhe caktimi i Vendeve të Numërimit të Votave (VNV). Edhe në këtë rast, Kodi Zgjedhor vendos për afat të fundit, për caktimin e vendodhjes së VNV-ve, 40 ditë para datës së zgjedhjeve⁶.

Vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e ka tejkalluar këtë afat edhe përgjatë kësaj periudhe të vëzhgimit.

Nëse është tejkalluar afati në këto raste për caktimin e vendodhjes së VNV-së, do të thotë që edhe proceset e tjera që vijnë pas nuk janë realizuar dhe rrezikojnë të mos bëhen korrektësisht nga nxitimi për përgatitjen e ditës së zgjedhjes.

Bëhet fjalë për këto vendime:

QV 30501 ... të kalojë në ambientin publik, shkolla 9-vjeçare me arsyetimin se ka më tepër hapësirë dhe favorizon mbarëvajtjen e procesit të votimit. (Nëpunësja Ndërlidhëse me KQZ-në, Bashkia Roskovec, me e-mail ka përcjellë kërkesën e Bashkisë Roskovec)

⁵ “Një ndryshim në Vendimin Nr. 446, datë 19.05.2015 “Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit për çdo qendër votimi për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore te datës 21 qershor 2015”.

⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012), Neni 94, “Vendndodhja dhe përgatitja e Vendeve të Numërimit të Votave”, pika 1 “... Jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 93 dhe të këtij neni. Jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, KQZ-ja me vendim cakton Vendin e Numërimit të Votave.”

- Vendimi numër 663, datë 17.06.2015, “Për një ndryshim në vendimin Nr.236, datë 07.05.2015, “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 82, Qarku Vlorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin numër 236, datë 07.05.2015, caktoi Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së numër 82, Qarku Vlorë, në sallën e katit të dytë, Universiteti “Ismail Qemali”, Bashkia Vlorë.

Me shkresën nr. 6233 datë 17.06.2015 KZAZ numër 82, i kërkoi Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndryshimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ nr 82. Në shkresë sqarohej se ky propozim, për ndërrimin e vendodhjes së VNV-së së ZAZ numër 82, bëhej për shkak se se ambienti i vënë në dispozicion, nuk i plotësonte kriteret e kërkuara në Kodin Zgjedhor, pasi nuk arrinte as 100 metra katrorë.

- Vendimi numër 596, datë 01.06.2015, “Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 64, Qarku Berat, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015.”

Në këtë rast nuk kemi ndryshim, por caktim të VNV-së me një vonesë rreth 20 ditore nga afati.

- Vendimi numër 562, datë 22.05.2015, “Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 42, Qarku Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015”

Në këtë rast nuk kemi ndryshim, por caktim të VNV-së me një vonesë rreth 10 ditore nga afati.

- Vendimi numër 564, datë 22.05.2015, “Për një ndryshim në vendimin Nr.335, datë 11.05.2015, “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 50, Qarku Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015”.

- Vendimi numër 563, datë 22.05.2015, “Për një ndryshim në vendimin Nr.335, datë 11.05.2015, “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr. 50, Qarku Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015”.

(Vendimi numër 563 dhe Vendimi numër 564 janë i njëjtë vendim. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i ka numërtuar me dy numra të ndryshme.)

C. RASTI I KANDIDATIT TË ALEANCËS POPULLORE PËR PUNË DHE DINJITET NË BASHKINË E KURBINIT

1. Ecuria institucionale e rastit

Komisioni i Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve (ZAZ) numër 15 në Qarkun e Lezhës, me vendimin nr. 50, datë 06.05.2015 vendosi të regjistrojë si kandidat për kryetar të Bashkisë së Kurbinit z. Altin Biba, i propozuar nga koalicioni “Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet” (APPD).

Pas kërkesës së paraqitur nga vetë kandidati për t’u ç’regjistruar, KZAZ-ja me vendimin nr. 54, datë 13.05.2015, vendosi shfuqizimin e vendimit të sipërcituar dhe ç’regjistrimin e kandidatit për Kryetar të Bashkisë së Kurbinit z. Altin Biba.

Në vazhden e këtij vendimi, me vendimin tjetër nr. 55, datë 13.05.2015 kjo KZAZ, mbështetur në kërkesën e koalicionit APPD, të bërë po më datë 13.05.2015, vendosi regjistrimin si kandidat për Kryetar të Bashkisë së Kurbinit z. Ilir Pjetraj.

Për të kundërshtuar vendimin nr. 55, datë 13.05.2015, të KZAZ-së nr. 15, Partia Socialiste e Shqipërisë (PS) iu drejtua Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Ky i fundit me vendimin nr. 493, datë 20.05.2015 vendosi: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr.55, datë 13.05.2015 të KZAZ nr.15, “Për regjistrimin e z. Ilir Pjetraj, si kandidat për kryetar bashkie Kurbin, propozuar nga koalicioni APPD dhe pranimin e kërkesës ankimore nr. 21, të Partisë Socialiste”.

Kundër vendimit të KQZ-së nr. 493, datë 20.05.2015, Partia Demokratike (PD) ngriti padi në Kolegjin Zgjedhor, i cili me vendimin nr. 13, datë 28.05.2015 vendosi:

- Shfuqizimin e vendimit nr. 493, datë 20.05.2015 të KQZ-së.
- Detyrimin e KQZ-së për të marrë në shqyrtim çështjen e regjistrimit të kandidatit të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet”, duke trajtuar në themel edhe kërkesën për dorëheqje të kandidatit Altin Biba dhe kërkesën e subjektit zgjedhor Koalicionit “Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet” për regjistrimin/zëvendësimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin, qarku Lezhë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015.

Në rrjedhojë të këtij vendimi të Kolegjit Zgjedhor, KQZ-ja në mbledhjen e datës 01.06.2015, mori në shqyrtim çështjen me objekt “Për ekzekutimin e vendimit të Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë nr. 13, datë 28.05.2015 për të marrë në shqyrtim çështjen e rregjistrimit të kandidatit të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Aleanca Popullore per Punë dhe Dinjitet”.

Mbi bazën e arsytimit të ndjekur në atë mbledhje, KQZ-ja vendosi:

- Mospranimin e dorëheqjes, të kandidatit për kryetar për Bashkinë Kurbin, propozuar nga Koalicioni “Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet”.
- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 54 dhe nr. 55 të KZAZ-së nr. 15.
- Lënien në fuqi të vendimit nr. 50, të KZAZ-së nr.15.

Sërisht subjekti zgjedhor PD, nëpërmjet padisë iu drejtua Kolegjit Zgjedhor, me datë 03.06.2015, ku kundërshtonte Vendimin nr. 593, datë 01.06.2015, të KQZ-së, duke kërkuar gjykimin e çështjes në themel dhe vendosur për pranimin e dorëheqjes së kandidatit z. Altin Biba dhe regjistrimin e kandidatit të Koalicionit APPD, z. Ilir Pjetraj.

Ky rekurs i dytë i Partisë Demokratike në Kolegjin Zgjedhor u rrëzua me Vendimin nr. 18, datë 05.06.2015.

Trupa e Kolegjit Zgjedhor e vlerësoi në këtë rast të drejtë vendimmarrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky vendim la si kandidat të Koalicionit APPD, z. Altin Biba.

2. Problematikat e vërejtura në ecurinë e rastit

Rasti i kandidaturës së Partisë Demokratike për Kryetar të Bashkisë së Kurbinit është voluminoz si në argumentat pro dhe kundër, si në diskutimin institucional ku u përfshi. Përsa u vu re, duhet ndalur në disa pika problematike.

a. *Së pari, Kodi Zgjedhor nuk e njeh institutin e dorëheqjes për kandidatët, që prej momentit të regjistrimit të kandidaturës deri kur, nëse shpallen fitues, marrin në dorëzim postin.*

Kjo mosnjohje e kuadrit ligjor duhet të shihet në dy momente: - kur dorëheqja vjen si vullnet i kandidatit dhe - për shkak të pamundësisë për të vazhduar garën (arsye shëndetësore, shqetësime familjare, apo të tjera të ngjashme).

Nëse hipotetikiisht hamendësohet se Kodi Zgjedhor do e kishte parashikuar institutin e dorëheqjes, do të duhej të parashikonte medoemos një afat për këtë. Një periudhë e arsyeshme larg ditës së zgjedhjeve, që do lejonte kandidatin të dorëhiqej dhe t'i lejonte subjektit politik përkatës të regjistronte një kandidaturë tjetër.

Në gjendjen e sotme, situata në thelb është pikërisht kjo. Deri në 50 ditë para ditës së zgjedhjeve lejohet regjistrimi i kandidatëve.

Kjo do të thotë, se kandidati para se të regjistrojë kandidaturën dhe të marrë përsipër detyrimet përkundrejt elektoratit duhet të reflektojë në lidhje me garën elektorale. Nëse kandidati për arsye subjektive (përfshi edhe trysnitë që do kërkonin t'a largonin nga gara), pas afatit 50 ditë para ditës së zgjedhjeve, vendos të dorëhiqet kostot i mbesin subjektit të vet politik.

Një parashikim i bërë drejtë edhe prej faktit që momenti i regjistrimit është i lidhur me hallka të tjera para dhe pasrëndëse në procesin zgjedhor.

Një “kthim prapa” i shkaktuar nga dorëheqja e kandidatit do të sillte problematika të tjera në organizimin zgjedhor⁷.

Ndërsa, përse i përket dorëheqjes për shkaqe madhore si ato shëndetësore, këtu mbase do nevojitej një trajtim ndryshe. Në këtë pikë, vërtetë legjislatori do duhet ta rregullojë si eventualitet.

b. *Së dyti, Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor (KZAZ) ka vepruar në diskrecionalitet të plotë, në rastin e kandidaturës së Altin Bibës për Kryetar Bashkie në Kurbin.*

Me datë 6 maj, KZAZ-ja regjistroi kandidaturën e Koalicionit APPD, z. Altin Biba.

Pas një kërkesë të dytë të Koalicionit me datë 13.05.2015, KZAZ nr. 15, pa asnjë lloj baze ligjore, pranoi ç' regjistrimin e kandidaturës së parë.

Në të njëjtën datë, jashtë çdo afati ligjor të parashikuar nga Kodi Zgjedhor, pranoi të regjistrojë edhe kandidaturën e dytë të Koalicionit Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet.

c. *Së treti, Kolegji Zgjedhor vazhdon të shfaqë tipare prej gjykate ligji dhe kërkon të bëhet burim i të drejtës zgjedhore.*

Me vendimin nr. 13 të datës 28.05.2015, kjo gjykatë argumentoi në një interpretim ligjor (të lirë) se instituti i dorëheqjes së kandidatëve qendron në dorë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si organi epror i Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor.

⁷ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 493, datë 20.05.2015: “... Kodi zgjedhor për të garantuar qëndrueshmëria e procesit të regjistrimit të kandidatëve dhe të gjitha proceseve të tjera të ndërvarura me të, në asnjë nen të tij nuk parashikon të drejtën e zëvendësimit, të kandidatëve. Por edhe nëse i referohemi normave ligjore të cilat kanë rregulluar proceset zgjedhore të mëparshme të cilat kanë parashikuar institutin e zëvendësimit të kandidatëve, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm brenda disa afateve të përcaktuara në ligj. E drejta pasive e votës, është një ndër elementet e të drejtës së zgjedhjes, të parashikuar nga neni 45 i Kushtetutës. Është ky nen, i cili parashikon kufizimet e para në lidhje me këtë të drejtë (mosha apo aftësia për të vepruar e subjektit të së drejtës, etj), ndërkohë që neni 17 i Kushtetutës parashikon se kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen edhe me ligj, për një interes publik.”

“... Kolegji Zgjedhor vlerëson se pavarësisht mënyrës së rregullimit të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar, KQZ-ja nuk duhej të mos e ushtronte një pushtet të tillë. Referuar përgjegjësisë që ka KQZ-ja, si organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, si edhe rregullimit të bërë në nenin 21/26 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, që i njeh të drejtën KQZ-së të kryejë edhe detyra të tjera, që burojnë nga ky Kod ose nga ligje të tjera, kur ato nuk kryhen nga komisionet e niveleve më të ulëta, Kolegji Zgjedhor vlerëson se KQZ-ja nuk ka përmbushur një detyrim që, sipas parimeve dhe vlerave të ligjit duhej të ishte përmbushur.”

d. Së katërti, Vendimmarrja e Kolegjit Zgjedhor vazhdon të jetë inkohente me veten. Pasazhi i mësipërm, krijon edhe një problematikë të dytë kur përballët me Vendimin nr. 18, datë 05.06.2015, po të Kolegjit Zgjedhor. Partia Demokratike, pas Vendimit nr. 593, datë 01.06.2015 të KQZ-së bën rekurs të dytë në Kolegji Zgjedhor. Këtë veprim e argumenton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk i ishte përgjigjur vendimit të Kolegjit Zgjedhor për ç’regjistrimin e kandidatit të dorëhequr dhe regjistrimin e të dytit.

Në këtë rekurs të dytë për të njëjtën çështje, Kolegji Zgjedhor argumenton se Partia Demokratike e kishte keqlexuar vendimin e saj të mëparshëm dhe se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte vepruar në përputhje me atë vendim.

“... Kolegji Zgjedhor vlerëson se pala paditëse gabon në konsideratat e saj për atë c’ka Kolegji Zgjedhor ka konkluduar në vendimin e tij nr. 13, datë 28.05.2015. Është e qartë se në vendimmarrjen e tij, Kolegji Zgjedhor ka pasqyruar me përpikmëri të gjithë historikun dhe kronologjinë e ngjarjeve që lidhen me mosmarrëveshjen zgjedhore, duke i evidentuar ato në raport dhe me pretendimet konkrete të palëve, subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në gjykim. Kolegji Zgjedhor ka konkluduar se KQZ-ja, si organi më i lartë shtetëror i ngarkuar nga ligji për administrimin e zgjedhjeve, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të trajtuar rastin në tërësi dhe për të dalë me një vendim përfundimtar në lidhje me ligjshmërinë e heqjes dorë të kandidatit për kryetar të Bashkisë Kurbin, z. Altin Biba, të propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni APPD, si dhe për procesin në tërësi të regjistrimit të kandidatit për kryetar bashkie, të propozuar nga subjekti zgjedhor në fjalë.”

Duke e marrë të mirëqenë argumentimin e mësipërm, pyetja që lind është se pse me vendimin numër 13, Kolegji Zgjedhor ia ktheu edhe njëherë për gjykim në themel çështjen Komisionit Qendror të Zgjedhjeve? Në të dyja rastet, edhe në vendimin para edhe në atë pas rekursit në Kolegjin Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi njësoj.

D. RASTI I KANDIDATIT TË ALEANCËS POPULLORE PËR PUNË DHE DINJITET NË BASHKINË E KËLCYRËS

1. *Ecuria institucionale e rastit*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me Vendimin nr. 548, datë 22.05.2015, miratoi përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për kryetar të Bashkisë së Këlcyrës.

Sipas vendimit renditja në fletën e votimit për kandidatët për kryetar Bashkia Këlcyrë ishte:

- Klement Ndoni renditej i pari në fletën e votimit;
- Gentian Muhameti renditej i dyti;
- Hazbi Kasaj renditej i treti;
- Bujar Fezga renditej i katërti;

Koalicioni Aleanca Popullore për Punësim dhe Dinjitet (APPD), në datën 30.05.2015, depozitoi një kërkesë në KQZ me nr. 5483 prot, për tërheqjen nga kandidimi të kandidatit z. Gentian Muhameti për kryetar të Bashkisë së Këlcyrës, Qarku Gjirokastrë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në seancën e datës 03.06.2015 mori në shqyrtim kërkesën e Koalicionit APPD.

Sipas subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet, kandidati refuzoi kërkesën e subjektit propozues për të verifikuar në lidhje me të kaluarën e kandidatit për pasjen ose jo të rekordeve kriminale. Edhe pse subjekti propozues nuk kishte asnjë provë që të vërtetonte pasjen ose jo të rekordeve kriminale, sipas tij, refuzimi prej kandidatit për ta bërë një gjë të tillë përbënte një indicie të mjaftueshme për të dyshuar.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, në seancë u paraqit përfaqësuesi i kandidatit për kryetar të Bashkisë së Këlcyrës z. Gentian Muhameti, me prokurë të posaçme nr.1884 Rep, z. Tauland Asllanaj, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës së Koalicionit APPD për tërheqjen e kandidatit, pasi pretendimi i tij ishte i pa mbështetur në ligj.

Sipas tij, Kodi Zgjedhor nuk parashikonte në asnjë dispozitë të tij të drejtën e një partie politike apo koalicioni zgjedhor që në përfundim të të gjitha procedurave për regjistrimin e kandidatëve, të kërkonte ç’regjistrimin e tyre.

Gjithashtu, sipas tij, subjekti propozues i kandidatit Gentian Muhameti, nuk kishte paraqitur asnjë provë për të vërtetuar pretendimet në lidhje me të kaluarën e kandidatit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi të investohej në hetimin e figurës së kandidatit. Me shkresën nr. 5559, datë 03.06.2015, vendosi të kërkonte të dhëna për z. Gentian Muhameti, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Informativ Shtetëror.

Duke qenë se brenda datës 09.06.2015 nga ato institucione nuk u paraqit asnjë informacion dhe duke qenë se koha për prodhimin e fletës së votimit ishte në limitet e fundit të saj, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi të vazhdonte shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga APPD, për ç’regjistrimin e kandidatit të tyre për Kryetar të Bashkisë së Këlcyrës, z. Gentian Muhameti.

Ndonëse nuk parashikohej një gjë e tillë prej kuadrit ligjor, sipas anëtarëve të KQZ-së, dyshimet mbi kandidatët do të çënonin rëndë procesin zgjedhor dhe imazhin e vendit.

Më këtë argumentim, kërkesa e koalicionit APPD u pranua dhe kandidati për kryetar i Bashkisë Këlcyrë, propozuar prej tij, u vendos të ç'regjistrohej.

Z. Gentian Muhameti pas vendimmarrjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve iu drejtua me rekurs Kolegjit Zgjedhor.

Ky i fundit, në seancën e datës 15.05.2015, rrëzoi padinë në fjalë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Problematikat e vërejtura në ecurinë e rastit

Në rastin e kandidaturës për Kryetar të Bashkisë - Këlcyrë, ndonëse pati një *unison* në vendimmarrjen e operatorëve zgjedhorë dhe subjekteve politike, precendi i krijuar, në gjykimin e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, është i rrezikshëm pasi:

a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr përsipër të jetë burim i së drejtës zgjedhore.

Fryma që shoqëroi çështjen në fjalë ishte përpjekja për dekriminalizimin e të zgjedhurve vendorë në veçanti dhe të zgjedhurve në përgjithësi. Një frymë që në çdo rast është përshendetut nga secili organizëm kombëtar dhe ndërkombëtar, i interesuar në zhvillimin e demokracisë në Shqipëri.

Gjithsesi, duhet theksuar se kjo është frymë dhe është në detyrën e legjislatorit ta trupëzojë në përmbajtjen e rregullimit ligjor.

Kur legjislatori nuk ia del dot mbanë të bëj një rregullim ligjor tërësisht në përputhje me këtë frymë, asnjë organi administrativ dhe ligjzbatues nuk mund t'i lind e drejta të vendosë norma dhe t'i japë vetes tagra që nuk i ka.

Duke e marrë të mirëqenë dhe duke e respektuar vullnetin pozitiv, në rastin në fjalë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk mund t'a ç'regjistronte kandidatin.

Vetë institucioni e pranon mangësinë ligjore⁸, por bazohet në një aspiratë demokratike siç është dekriminalizimi (që në jurisprudencë ka një kuptim krejt tjetër nga ai i përdorur në retorikën politike).

b) Në frymën e kësaj aspirote në fakt, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shkel prezumimin e pafajësisë dhe është diskrecional.

Shkelja e prezumimit të pafajësisë agravohet më shumë kur vetë kuadri ligjor nuk e kërkon si kusht pastërtinë penale të kandidatëve për Kryetarë të Bashkive.

Në nenin 63 të Kodit Zgjedhor (pika 3 dhe pika 4), nuk vendoset një kusht i tillë për figurën e kandidatit⁹. Pra, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke hamendësuar një

⁸ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 625, datë 09.06.2015: “Kodi Zgjedhor nuk parashikon asnjë dispozitë në të cilën të parashikohet e drejta e partive politike apo koalicioneve zgjedhore për të kërkuar tërheqjen/zëvendësimin/çregjistrimin e kandidatëve pas regjistrimit përfundimtar të tyre nga komisionet përkatëse KQZ/KZAZ.”

⁹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012), Neni 63 “Subjektet zgjedhore dhe kandidatët”, pika “3. Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie ose për këshillat vendorë në KZAZ.

4. Përveç kushteve të parashikuara në pikën 3, nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen pa hequr dorë më parë nga detyra:

a) gjyqtarët, prokurorët;

element të figurës së kandidatit, të cilin Kodi Zgjedhor nuk e njeh si shkak për mosregjistrim, merr përsipër t'a ç'regjistrojë, një tagër ky që po prapë Kodi Zgjedhor nuk ia njeh.

c) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendos precedent negativ me shkeljen e prezumimit të pafajësisë me vendimmarrjen e saj.

Nëse në të ardhmen, një forcë politike kërkon ç' regjistrimin e kandidatit kundërshtar se ka indicie ose dyshim se ka të shkuar me dënim penal, si do veprjë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi në standartin e vendosur do të duhej t'a ç' regjistronte duke i lënë shteg një situatë absurde.

E. RASTI I KANDIDATIT TË PAVARUR PËR KRYETAR TË BASHKISË SË MEMALIAJT

1. Ecuria institucionale e rastit

Kandidati Lulëzim Meci u regjistrua në Komisionin Zonal të Administrimit Zgjedhor nr. 76 si kandidat për Kryetar i Bashkisë Memaliaj me Vendimin nr. 5 datë 07.05.2015. Me datë 13.05.2015, kandidati dorëzoi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve shkresën me Nr. 4583 Prot ku kërkonte ç' regjistrimin si kandidat për Kryetar Bashkie me arsyen për “shkaqe shëndetësore dhe familjare”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 02.06.2015, me Vendimin nr. 608 “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkia Memaliaj për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 qershor 2015”, e pranoi kërkesën në fjalë.

2. Problematikat e vërejtura në ecurinë e rastit

a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendimmarrje diskrecionale dhe inkohente.

Ky institucion pranon tërheqjen nga gara të kandidatit, duke e ç' regjistruar.

Së pari, ky vendim bie në kundërshtim me Vendimin e vetë KQZ-së me nr. 593, datë 01.06.2015 (rasti i Kurbinut), ku ai nuk e pranoi kërkesën për ç' regjistrim të kandidatit z. Altin Biba.

Së dyti, vendimi për këtë rast nuk ka asnjë bazë ligjore në Kodin Zgjedhor. Argumentimi që bëhet në vendim është si vijon:

b) ushtarakët e shërbimit aktiv;

c) punonjësit e policisë dhe të sigurimit kombëtar;

ç) përfaqësuesit diplomatikë;

d) kryetarët e bashkive për zgjedhjet në Kuvend;

dh) deputetët, kur konkurrojnë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore;

e) prefektët në vendet ku kryejnë detyrat e tyre për zgjedhjet në Kuvend dhe për organet e qeverisjes vendore;

ë) kryetarët dhe anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve;

f) Presidenti i Republikës;

g) zyrtarët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuar me ligj”

“Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shqyrtoi dorëheqjen e paraqiturnepërputhje me standartet e përmenduradhenëvendimin nr. 13, datë 28.05.2015 të Kolegjit duke vlerësuar njëlkohësisht dhe kufijtë e caktuar nga Kodi i Zgjedhjeve dhe konstatojnë se:

Z. Agim Kaçani është kandidati I propozuar nga zgjedhësit, kandidimi i tij sikundër kandidat për kryetar të Bashkisë bazohet vetëm në shprehjen e vullnetit të tij pa çenuar të drejtat e subjekteve të tjerazgjedhore.

Nisur nga fakti se vullneti i shprehur i kandidatit z. Agim Kacani, përdore heqjen lehtëson dhe gapikë pamjet e teknike të printimit të fletës së votimit në këtë zonë, kjo dorëheqje duhet pranuar.”

(Gabimet drejtshkrimore dhe materiale janë të vetë tekstit origjinal të vendimit.)

Pra si bazë ligjore përdoret Vendimi nr. 13 i Kolegjit Zgjedhor. Ky vendim linte të kuptohej që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka tagër për ç’regjistrimin e kandidatëve. Ndonëse vendimi e pranon që Kodi i Zgjedhor nuk ia jep këtë tagër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, argumenton nga ana tjetër se KQZ-ja e merr këtë tagër falë Kodit të Procedurës Administrative.

Inkoherenca e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lind për shkak se me Vendimin nr. 593, datë 01.06.2015 nuk e mori për bazë këtë vendim të Kolegjit Zgjedhor, i cili ishte pikërisht për të njëjtën çështje që po diskutonte.

Gjithashtu, edhe vetë Kolegji Zgjedhor me Vendimin nr. 18 do e replikonte Vendimin nr. 13, si të keqlexuar.

Diskrecionaliteti i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve shkon më tej në motivimin përse pranoi ç’regjistrimin e kandidaturës duke theksuar ndër të tjera se: “... Vullneti i shprehur i kandidatit për dorëheqjen lehtëson dhe nga pikëpamja teknike e printimit të fletës së votimit në këtë zonë.”

Kjo pas, nëse hiqej emri i një kandidati nga lista e kandidatëve në fletën e votimit, bëhej më e lehtë përgatitja e fletës për printim.

b. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve publikon një akt me gabime të rënda drejtshkrimore dhe me gabime materiale. (I cituar më lart)

Në një pjesë të aktit, në dy momente, në vend të emrit “Lulëzim Meci”, përmendet emri “Agim Kaçani”, i cili ishte kandidat i propozuar nga zgjedhësit për Këshillin Bashkiak në Korçë.

F. LISTAT E ZGJEDHËSVE

Hartimi, përgatitja dhe publikimi i listës së zgjedhësve është një pjesë e përgatitjes zgjedhore që Kodi i Zgjedhor ka arritur t’u rregullojë më së miri.

Periudha që ligji ia kushton kësaj përgatitje fillon 30 ditë pas dekretimit të datës së zgjedhjeve¹⁰ (data 14 janar 2015) dhe shkon deri 40 ditë para datës kur mbahen zgjedhjet¹¹ (data 11 Maj 2015).

¹⁰ Kodi i Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012), Neni 51, “Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë”, pika 5..

¹¹ Kodi i Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012), Neni 56, “Përgatitja dhe shpallja e listës së zgjedhësve”, pika 1.

Shtrirja e këtij raporti vëzhgimi nuk do të duhej të kishte në vëmendje çështjen e listave të zgjedhësve, pasi do duhej të ishte një etapë zgjedhore e konkluduar, por ngjarjet e ndjekura gjatë kësaj periudhe e kanë sjellë si shqetësim.

1. Votuesit që vuajnë dënimin pranë Institucioneve të Ekzekutimit të Veprave Penale
Problematika ka të bëjë me listat e votuesve që vuajnë heqjen e lirisë në institucionet penitenciare.

Sipas raportimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve z. Artur Zoto në mbledhjen e datës 16.06.2015 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga 5,798 të burgosur, vetëm 5,168 kanë të drejtë vote. Pjesa tjetër janë shtetas të huaj dhe minorene, grup ky i privuar nga e drejta e votës.

Për këta 5,798 votues është deklaruar se ka probleme në përfshirjen e tyre në listat e zgjedhësve.

Megjithatë nuk ka patur një pasqyrë të saktë mbi problematikën, për të mos shtruar në diskutim se cila qe arsyeja që në katër muaj, Gjendja Civile nuk arriti të vinte re problematikën.

Bëhet fjalë për persona që duhet të jenë në evidencën më të plotë dhe të saktë për Gjendjen Civile¹².

Në tërësinë që mund të mbartë kjo problematikë linidin një sërë pyetjesh për të cilat kërkohet një transparencë e plotë si:

- sa të burgosur janë të regjistruar në vendbanimet e tyre?
- sa janë të regjistruar në institucionet ku vuajnë heqjen e lirisë?
- cilat janë masat konkrete që do merren për t'iu mundësuar këtyre personave të drejtën e votimit?
- cila do të jetë zgjidhja ligjore që do ndërmerret për të mundësuar votimin e tyre, duke qenë se tërë afatet janë tejkaluara?

Në lidhje me këtë çështje Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, znj. Lefterije Luzi zhvilloi një takim në datë 04.06.2015 me Ministrin e Drejtësisë, z. Nasip Naço, dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, z. Artur Zoto¹³.

¹² Ligji “Për Gjendjen Civile”, Nr. 10129, datë 11.05.2009, në nenin 18, pika 2:

“... Institucioni përgjegjës njofton zyrën kompetente të gjendjes civile, jo më vonë se 48 orë nga regjistrimi në institucionin i shtetasit. Vendbanimi i shtetasit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, regjistrohet drejtpërdrejt nga zyra e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial institucionin përkatës, me marrjen e njoftimit nga institucioni.”

¹³ Njoftim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

“... Gjatë takimit u diskutua mosregjistrimi në kohën e duhur, i vendbanimit në RKGJC të shtetasve që vuajnë dënimin në disa institucione të ekzekutimit të vendimeve penale (Durrës, Lushnjë dhe Sarandë) dhe si pasojë këta shtetas nuk janë përfshirë në listën e zgjedhësve, shqetësim ky, i ngritur në raportet e auditëve teknikienë, për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të RKGJC-së për përgatitjen e listës së zgjedhësve për zgjedhjet vendore, të datës 21 qershor 2015.

Duke qenë se, në bazë të Kodit Zgjedhor, “Lista e zgjedhësve nuk ndryshon në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak pas afatit të parashikuar në pikën 1 (jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve)”, zgjidhja e vetme për t’i përfshirë këta shtetas në listën e zgjedhësve, është ajo e paraqitjes së kërkesës në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës.

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, zj. Luzi, Ministri i Drejtësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, kanë dakord që të merren masat e menjëhershme për t’u bërë në mënyrë të organizuar e të

Më herët me datë 28.05.2015, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë iu drejtua me shkresë për informim Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në lidhje me situatën e këtyre listave¹⁴.

Megjithë shkresën kujtuese të Ministrisë së Drejtësisë drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve me datë 11.06.2015¹⁵, asnjë informacion nuk i është komunikuar KVV-së në lidhje me gjendjen e listave të të burgosurve.

2. Zhvendosja e votuesve

Një diskutim tjetër që po shoqëron listat e zgjedhësve ka të bëjë me transferimin e gjendjeve civile të votuesve.

Prej të dyja koalicioneve kryesore janë ngritur akuza se janë kryer transferime artificiale të gjendjeve civile me qëllim për të modeluar rezultatet elektorale në interes të subjekteve zgjedhore. Bashkitë ku janë ngritur akuza të tilla janë ato të Durrësit, Vorës dhe Kavajës.

Edhe auditit teknikien Armand Teliti, në raportet dhe gjetjet e tij e ka mbështetur këtë shqetësim për Gjendjen Civile të Bashkisë së Durrës¹⁶ dhe për Gjendjen Civile të Bashkisë së Kavajës¹⁷.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ia ka përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme dy raportet e auditit teknikien mbi këtë çështje.

Për këtë problematikë janë investuar me kërkesë të Partisë Demokratike edhe dy prokurori rrethesh; Prokuroria Durrës dhe Prokuroria Kavajë.

E nxitur nga kallzimi penal i depozituar prej Partisë Demokratike - Dega Kavajë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë ka regjistruar çështjen penale nr.186 për veprat penale të parashikuara nga nenet 248-186/ dhe 191/ të Kodit Penal.

shpejtë, kërkesë pranë gjykatave përkatëse për përfshirjen e këtyre shtetasve në listën e zgjedhësve dhe më pas ngritja e qendrave të votimit të posaçme.”

<http://www.2.cec.org.al/sq-al/activities/ID/326/Kryetarja-e-KOZ-se-zj-Lefterije-Luzi-zhvilloi-nje-takim-me-Ministrin-e-Drejtësisë-z-Nasip-Naco-dhe-Drejtorin-e-Përgjithshëm-te-Burgjeve-z-Artur-Zoto>

¹⁴ Shkresë drejtuar Drejtorisë Përgjithshme të Burgjeve, Z. Artur Zoto.

Për dijeni: Ministrit të Drejtësisë z. Nasip Naço, Ministrit të Brendshëm z. Saimir Tahiri, Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, z. Bledar Doracaj. Nr. 0529/1B Prot., datë 28/05/2015.

¹⁵ Shkresë drejtuar Drejtorit të Burgjeve, Nr. 3915/2, datë 11.06.2015

¹⁶ Vendimi numër 195, datë 04.05.2015, “Për Shqyrtimin e raportit të auditit teknikien, Armand Teliti “Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të regjistrit kombëtar të gjendjes civile për bashkinë Durrës””.

“... Përdorimi për këtë proces i kontratave shumë të dyshimta të privatëve mes njëri tjetrit në një periudhë shumë të ngjeshur, në ditë të përqëndruara, me të njëjtën noter apo me vetëm 2 kompani ndërtimërp kontratat e sipërmarrjes dhe veçanërisht përdorimi i asetëve pronësi të Bashkisë së Durrësit dhe përfshirja e Ndërmarrjes Shtetërore të Komunales Plazh në këtë operacion, kur njëri nga kandidatët në garë është Kryetari aktual i Bashkisë së Durrësit, shtojnë dyshimet dhe i bëjnë ato edhe më të arsyeshme se ndodhemi përpara një krimi elektorale me synim ndryshimin e rezultatit të zgjedhjeve në Bashkinë e Durrësit.”

¹⁷ Vendimi numër 592, datë 28.05.2015, “Për Shqyrtimin e raportit të auditit teknikien, Armand Teliti “Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të regjistrit kombëtar të gjendjes civile për bashkinë Kavajë””.

“... Në përfundim të auditimit, pas krahasimit dhe vlerësimit të statistikave të hyrjeve në periudhën parazgjedhore, në periudhën Janar-Prill 2015 dhe dy javët e fundit para shpalljes së listës përfundimtare 28 Prill deri në 13 Maj 2015 në Bashkinë e Kavajës, pas shqyrtimit të dokumentacionit të gjetur në dosjet e kontrolluara në ZGJC e Bashkisë Kavajë ekziston një dyshim shumë i arsyeshëm se ndodhemi para një zhvendosjeje të votuesve për qëllime elektorale e ngjashme me rastin e Bashkisë Durrës.”

“Nga kallzimi penal rezultoi se një numër i konsiderueshëm familjesh (250 kryefamiljarë) nga qytete dhe njësi vendore të tjera, për një periudhë relativisht të shkurtër parazgjedhore (nga data 20.04.2015 – 30.04.2015) kishin kryer transferimin e gjendjes civile të mëparshme duke u regjistruar në zyrën e gjendjes civile Kavajë¹⁸”.

Edhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, bazuar në kallzimin e Partisë Demokratike dhe materialit kallzues të auditit teknikien të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka regjistruar dhe ka filluar procedimin penal nr. 916 datë 22.05.2015 për veprat penale:

- Fallsifikim i dokumentave nga personi që ka për detyrë dhe në bashkëpunim
- Shpërdorim i detyrës
- Fallsifikim kompjuterik

“Në funksion të hetimit, me vendim numër 337, datë 09.06.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, është vendosur “sekuestrimi i të dhënave kompjuterike në lidhje me përbërësit e gjendjes civile që i përkasin shtetasve sipas listës bashkëlidhur vendimit, pjesë integrale e tij, duke urdhëruar ndalimin e kryerjes së veprimeve të mëtejshme në këto të dhëna nga Zyra e Gjendjes Civile”. Ky vendim me datë 10.06.2015 i është dërguar për ekzekutim Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile Tiranë, të cilës i është dërguar dhe lista e shtetasve të cilët dyshohen se janë regjistruar në mënyrë fiktive.”¹⁹

Këto çështje janë ende pjesë e diskutimeve në KQZ si dhe pjesë e hetimeve të mëtejshme të Prokurorisë.

¹⁸ Shkresë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë. Lënda: Kthim përgjigje, Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Nr. 2064, datë 15.06.2015.

¹⁹ Shkresë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, Lënda: Kthim përgjigje, Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Nr. 8699/1, datë 16.06.2015.

III. TË DHËNA TË KONSTATUARA

A. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

A.1. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Në periudhën 22 Maj – 18 qershor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka zhvilluar 15 mbledhje dhe ka marrë gjithësej 164 vendime, shumica e të cilave konsistojnë në miratim vëzhguesish, miratim përmbajtje flete votimi, e të tjera elementë përgatitorë.

Përgjithësisht vendimmarrja e KQZ-së është karakterizuar nga konsensusi, por ka patur edhe vendime si ç'regjistrimi dhe refuzimi i kërkesave për ç'regjistrim të disa kandidatëve, caktimi i partive politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, vendimmarrja për raportet e BMM-së, për të cilat vendimmarrja ka qenë jo konsensuale. Në këtë vazhdë, 10 vendime janë marrë me 4 vota pro dhe 3 kundër, 1 vendim është marrë me 4 vota pro dhe 0 kundër, 1 vendim me 5 vota pro dhe 2 kundër dhe pjesa tjetër e vendimeve është në unanimitet 7 me 0.

Disa nga vendimarrjet e KQZ kanë qenë të pabazuara në ligj, si vendimi për ç'regjistrimin e disa kandidatëve, vendimi për raportin e parë dhe të dytë të BMM, ku u vendos kompesimi i minutazhit nga ana e disa televizioneve.

Një pjesë e vendimeve nuk janë të pasqyruara në faqen zyrtare të KQZ, konkretisht vendimet nr.649, nr. 650, nr. 651, nr. 652, nr. 653, nr. 661, nr. 664 – nr.669.

Vendimet e KQZ të vendosura në faqen web, nuk pasqyrojnë votimin pro dhe kundër nga trupa e KQZ në lidhje me atë vendimmarrje.

Gjithashtu në shumë raste materialet paraprake të mbledhjeve mungojnë²⁰ ose janë të paplota në faqen e internetit të KQZ.

Vendimi 563 dhe 564 të publikuar me numër rendor të ndryshëm në faqen web²¹, kanë të njëjtën përmbajtje.

Është për t'u vlerësuar aktiviteti i KQZ-së e veçanërisht angazhimi i Kryetares së tij në realizimin e fushatës së edukimit të zgjedhësve, duke realizuar ndër të tjera edhe takime me përfaqësues të pakicave kombëtare në qytete të ndryshme²², të rinjtë etj.

A.2. KOMISIONET E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, do të administrohen në nivelin e dytë nga 90 Komisione Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ). KZAZ-të u konstituan në 13 Prill 2015²³.

²⁰ Mungojnë materialet e mbledhjes së datës 3 qershor 2015 dhe 18 qershor 2015; ndërkohë që janë pjesërisht materialet për të gjitha mbledhjet e tjera.

²¹ <http://www2.cec.org.al/sq-al/Legjislacioni/Aktet-e-KQZ-s%C3%AB/Vendimet/Vendimet-2015>

²² Takim me përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian, takim me komunitetin Maqedonas në Bashkinë Pustec, takim me komunitetin grek në Dervican.

²³ Vendim nr. 133 datë 13.04.2015 “ Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015”

Kodi Zgjedhor përcakton kuotën gjinore²⁴ prej 30 % për anëtarët e KZAZ-ve të propozuar nga dy partitë më të mëdha, të cilat janë respektuar pavarësisht ndryshimeve të shpeshta të kryera.

Trajnimi dhe ndryshimi i anëtarëve të KZAZ-ve

Ndryshimi i anëtarëve të KZAZ-ve prej partive politike që i propozojnë ato, vazhdon të mbetet problem edhe në periudhën e mbuluar nga ky raport. Në total, gjatë kësaj periudhe KQZ ka marrë 12 vendime për lirim dhe emërim të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, nëpërmjet të cilave janë zëvendësuar 130 (20,6% e totalit të trupës së anëtarëve të KZAZ-ve) të tillë²⁵.

Pavarësisht se Kodi Zgjedhor nuk vë asnjë limit për ndryshimin e anëtarëve të KZAZ-ve nga subjektet politike, praktika e ndryshimit të tyre pa kriter krijon pengesa artificiale të procesit²⁶ dhe e kthen atë nga një proces me natyrë administrative në një proces politik.

Trupa e anëtarëve të KZAZ-ve u është nënshtruar dy trajnimeve, i pari prej të cilëve prej 15 Prill 2015 deri në 5 Maj 2015 dhe i dyti në datat 2, 3 dhe 4 qershor²⁷. Pas trajnimit të dytë anëtarët e KZAZ-ve i janë nënshtruar edhe një testimi.

Baza materiale e nevojshme

Për funksionimin normal të KZAZ-ve parashikohet vënia në dispozicion e pajisjeve, e bazës së nevojshme materiale si dhe e rrjetit të komunikimit e veçanërisht pajisja me linjë telefonike të rrjetit fiks.

Nga monitorimi i KVV është vërejtur se në shumë KZAZ situata në lidhje me bazën materiale vazhdon të jetë problematike²⁸, në vazhdim të situatës së vërejtur gjatë periudhës nga 27 marsi deri në 21 maj të mbuluar në Raportin e Dytë të Monitorimit²⁹.

Një problematikë e ngritur nga anëtarët e disa KZAZ-ve, veçanërisht atyre me shtrirje të madhe gjeografike, ka qenë buxheti i ulët në dispozicion për transportin e cila i vështirëson mundësitë konkrete për të vizituar zonën në rastet kur lindin probleme.

Mbledhjet e KZAZ-ve dhe orari i punës së tyre

²⁴ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr. 74/2012), Neni 29 “Përbërja e KZAZ-së” pika: 1/ç “30 për qind e anëtarëve të propozuar përkatësisht nga partia më e madhe e shumicës dhe partia më e madhe e opozitës, në shkallë vendi, duhet të jenë nga secila gjini.”

²⁵ Respektivisht, PS ka ndryshuar 74 anëtarë, PD ka ndryshuar 35 anëtarë, LSI ka ndryshuar 7 anëtarë dhe PR ka ndryshuar 14 anëtarë.

²⁶ Në KZAZ nr. 1, pasi kryetari i saj është ndërruar, ai është larguar nga pozicioni pa e kaluar detyrën tek pasardhësi i tij, duke krijuar vështirësi.

Ndërsa në KZAZ 80 ka një situatë absurde. Ndërsa një anëtar është ndërruar, vendimi i KQZ për ndërrimin e tij nuk ka mbërritur ende në KZAZ duke e lënë de facto akoma në detyrë këtë anëtar, anëtarë me të cilin është zëvendësuar gjithashtu paraqitet në detyrë që prej datës 15 qershor duke qenë se në faqen zyrtare të KQZ tanimë figuron emri i tij.

²⁷ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. *Njoftim për Shtyp 05.06.2015, Informacion për programin e dytë të trajnimit të KZAZ-ve.* <http://www2.cec.org.al/sq-al/Kreu/ID/345/Njoftim-per-shtyp-05062015>.

²⁸ Telefoni fiks mungon në KZAZ-të me nr. 55, 38, 11, 15, 22, 24, 43, 45, 47, 49, 59, 41, 68, 71, 72, 80 dhe 52; kompjuter në KZAZ-të 81, 15, 34; printer në KZAZ-të 81, 15, 68 dhe 34; fotokopje në KZAZ-të 11, 15, 47, 49, 68, 71, 72 dhe 52; dhe lidhja me internet në KZAZ-të 81, 68 dhe 33.

²⁹ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë. *Raportin e Dytë të Monitorimit për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 21 Qershorit 2015, Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (fq. 24).* <http://zgjedhje.al/uploads/File/2014-2015/KVV-RaportinDermjetemMonitorimi-II-ZgjedhjeLokale2015-4Qershor2015.pdf>.

Shqetësues vazhdon të mbetet funksionimi i KZAZ-ve jashtë orarit të përcaktuar në udhëzimin e KQZ-së³⁰.

Nga monitorimi i kryer rezulton se në pothuajse asnjë rast ky orar nuk respektohet nga anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve.

Punësimi i anëtarëve të KZAZ-ve, veçanërisht në institucione shtetërore qendrore apo lokale është një nga arsyet për mosrespektimin e orarit të punës.

Vendimmarrja e KZAZ-ve

Nga vëzhgimi i kryer rezulton se në shumicën e KZAZ-ve vendimmarrja ka qenë përgjithësisht unanime, me pak raste të vendimeve të marra me shumicë të thjeshtë.

A.3. KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT

Procesi zgjedhor do të administrohet në ditën e zgjedhjeve nga 5299 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV), nga të cilat 4862 janë të vendosura në ambjente publike, 417 QV janë të vendosura në ambjente private me vendim të KQZ, dhe 20 QV janë të vendosura në institucione të posaçme.

KQV është përgjegjëse për mbarëvajtjen e votimit në qendrën përkatëse të votimit. Ai është organ kolegjal, i cili përbëhet nga shtatë anëtarë ku njëri prej tyre kryen detyrën e sekretarit. Përbërja e KQV-ve është e tillë që respekton balancën politike³¹. Anëtarët dhe sekretari i KQV emërohen nga KZAZ-ja nën juridiksioni territorial të së cilës ndodhet Qendra e Votimit.

Afati përfundimtar për ngritjen e KQV-ve ishte data 1 qershor 2015³². Në disa KZAZ³³ ende nuk u realizua ngritja e KQV-ve, ndërsa në disa KZAZ³⁴ të tjera ky proces u realizua jashtë afateve ligjore.

Përgjithësisht pjesëmarrja në trajnimet e zhvilluara për komisionerët e Qendrave të Votimit, pjesëmarrja ka qenë e ulët³⁵. Përpos kësaj shtohet edhe problematika e ndryshimit të shpeshtë të anëtarëve të KQV-ve.

Vendndodhja e QV-ve

Procesi i caktimit të vendndodhjes së Qendrave të Votimit, realizohet si rrjedhojë e një ndërveprimi midis Njësisë të Qeverisjes Vendore (NJQV) dhe KQZ. Kështu, pasi NJQV-të çojnë propozimet e tyre në KQZ, kjo e fundit pasi bën verifikimet e nevojshme, merr vendim final për caktimin e adresës së QV.

Sipas nenit 62 pika 4³⁶ të Kodit Zgjedhor, ky proces duhet të përfundojë jo më vonë se data 12 Maj 2015, dhe KQZ mund të marrë vendime për ndryshim të adresave të QV-ve vetëm në raste të forcave madhore.

³⁰ Udhëzimi nr. 2 i KQZ-së, datë 25.02.2009, në nenin 18 të tij përcakton se “Gjatë periudhës zgjedhore dhe deri tre ditë para datës së zgjedhjeve, KZAZ-ja punon paradite nga ora 08.00 – 13.00 dhe pasdite 16.00 - 20.00”.

³¹ 3 anëtarë nga parti politike të shumicës parlamentare (2 PS dhe 1 LSI), 3 anëtarë të opozitës parlamentare (2 PD dhe 1 PR) dhe sekretari i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin.

³² Udhëzimi nr. 2 datë 04.03.2015 i KQZ; neni 7 “Emërimi i anëtarëve të KQV-së” pika 3 “Në çdo rast emërimi i anëtarëve dhe sekretarëve të KQV-ve bëhet jo më vonë se 20 ditë para datës së zgjedhjeve.”

³³ KZAZ nr. 90, nr. 45, nr. 47, nr. 49, etj.

³⁴ KZAZ nr. 1, nr. 6, nr. 10, nr. 11, nr. 26, nr. 6, etj.

³⁵ KZAZ nr. 10, nr. 11, nr. 6, nr. 1, etj.

KQZ në datën 10 Qershor 2015, me vendimin nr. 630 ka marrë vendim për ndryshimin e vendndodhjes për 21 QV. Gjithashtu KQZ në datën 16 Qershor 2015 me vendimin nr. 660 ka marrë vendim për ndryshimin e vendndodhjes së 10 QV-ve. Në datën 17 Qershor 2015 me vendimin nr. 670 KQZ ka marrë vendim për ndryshimin e vendndodhjes së 2 QV-ve dhe me vendimmarrjen e datës 18 Qershor është vendosur ndryshimi i adresës për 10 QV.

Në asnjë rast, pavarësisht se jashtë afateve ligjore, në arsyetimin e vendimit të KQZ nuk cilësohet si arsye për vendimmarrje jashtë afatit të përcaktuar ligjor *forca madhore*, elementi i vetëm që cilëson kodi zgjedhor si arsye për ndryshimin e vendndodhjes së QV-ve.

A.4. VENDET DHE GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE

Procesi i numërimit të votave administrohet nga 90 Vende të Numërimit të Votave (VNV). Vendndodhja e VNV-ve caktohet me vendim nga KQZ pas propozimeve nga prefektët. Sipas Kodit Zgjedhor³⁷ afati i fundit për caktimin e adresave të VNV-ve ishte data 12 Maj 2015.

KQZ nuk e mbylli këtë proces brenda këtij afati. Edhe pas datës 12 Maj 2015 ka patur vendime për caktim³⁸ adresash të VNV-ve si dhe ndryshime të adresës³⁹ së përcaktuar me vendim nga KQZ.

Në çdo VNV caktohen Grupet e Numërimit të Votave (GNV). GNV ngrihen nga KZAZ-ja, pas propozimeve nga partitë politike. Sipas Kodit Zgjedhor dy anëtarë propozohen nga partitë e mëdha të shumicës parlamentare dhe pakicës parlamentare, ndërsa anëtari i tretë dhe i katërt zgjidhen duke i'u referuar nenit 95 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Pas vendimmarrjes së fundit të KQZ dhe më pas Kolegjit Zgjedhor, partitë që kanë të drejtë të propozojnë antarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve janë LSI dhe PR. Referuar udhëzimit nr. 4 datë 09.04.2015, KZAZ-ja përcakton numrin e GNV-ve që do të ngrihen për çdo VNV.

Procesi i numërimit të votave do të realizohet nga 880 GNV në të gjithë vendin, pra nga një trupë prej 3.520 numërues.

Sipas raportimeve të vëzhguesve afatgjatë të KVV, përgjithësisht partitë politike i kanë çuar propozimet e tyre për anëtarë të GNV-ve, pranë KZAZ-ve përkatëse. Pothuajse në asnjë rast trajnimi i tyre nuk ka filluar.

³⁶ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012), neni 62 “Caktimi i zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit”, pika 4.

³⁷ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012), Neni 94 “Vendndodhja dhe përgatitja e Vendeve të Numërimit të Votave”, pika 1.

³⁸ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendimi nr. 562 datë 22.05.2015, vendimi nr. 596 datë 01.06.2015

³⁹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendim nr. 663 datë 17.06.2015, vendim 564 datë 22.05.2015.

B. FUSHATA ZGJEDHORE

Neni 77 i Kodit Zgjedhor⁴⁰, përcakton se fushata zgjedhore fillon 30 ditë përpara datës së zgjedhjeve (22 maj) dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve (19 qershor), pavarësisht se, sikundër është bërë praktikë, partitë politike e filluan këtë fushatë gati një muaj më parë në shkelje të afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Format mbizotëruese të komunikimit me zgjedhësit

Fushata ka qenë e ndërtuar kryesisht në formën e takimeve të ngushta me komunitetin nga ana e kandidatëve për kryetarë⁴¹, ndërkohë që mitingjet masive janë rezervuar për takimet elektorale në të cilat kanë qenë prezentë drejtuesit e partive kryesore të koalicioneve.

Nën këtë optikë, edhe në këtë raund zgjedhor, pavarësisht se zgjedhje për pushtetin vendor, fushata ka vuajtur nga protagonizmi i kandidatëve për kryetar bashkie apo i drejtuesve të partive.

Kandidatët për këshillin bashkiak kanë patur një rol të papërfillshëm gjatë fushatës, në rastin më të mirë ata kanë shërbyer si dekor dhe shoqërues të kandidatëve për kryetar bashkie.

Një vëmendje e veçantë, veçanërisht nga dy koalicionet kryesore, i është kushtuar marketingut elektorale në formën e reklamave të vendosura në rrugë, flamurëve e banderolave në shtyllat e ndriçimit, shpërndarjes së fletëpalosjeve derë më derë dhe reklamës në mediat elektronike.

Në përgjithësi mund të thuhet se fushata ka qenë e kushtueshme dhe e bazuar në marketing e slogane elektorale më tepër se në programe apo oferta konkrete e të arsyetuara bindshëm.

Konfliktualiteti politik gjatë fushatës

Një karakteristikë e fushatës zgjedhore, e cila është e qëndrueshme në politikën shqiptare, ka qenë mungesa e vullnetit të kandidatëve për kryetarë bashkie të përballen me njëri-tjetrin në takime elektorale, duke e realizuar fushatën, në rastin më të mirë në injorim të kandidatit të koalicionit kundërshtar dhe në rastin më të keq në mesazhe publike denigruese ndaj tyre.

Edhe në këtë fushatë debatet mes kandidatëve kanë qenë të pakta, ndërkohë që për përballje të kandidatëve për këshilltarë as nuk është folur.

Në tentativë për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e kandidatëve për kryetarë bashkie dhe këshill bashkiak, KVV nisi të realizojë një cikël forumesh mes kandidatëve dhe qytetarëve në disa bashki të vendit, me pjesëmarrjen e kandidatëve nga dy koalicionet kryesore në vend.

⁴⁰ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 10 019, datë 29.12.2008, ndryshuar me ligjin nr.74/2012). Neni 77 “Periudha e fushatës dhe heshtjes zgjedhore”, pika 1 “1.Fushata zgjedhore fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve.” http://www.parlament.al/web/pub/kodi_zgjedhor_i_azhornuar_pdf_web_15174_1.pdf.

⁴¹ Një pjesë e konsiderueshme e takimeve me komunitetin të kandidatëve ka qenë i filmuar me regji qëndrore dhe kanë qenë shtabet elektorale të kandidatëve që kanë shpërndarë kasetat e gatshme për mediat, ndërkohë që takimet janë transmetuar në shumicën e kohës në kohë reale nga televizionet informative.

Vlen të theksohet vështirësia e shfaqur midis kandidatëve për t'u ulur dhe komunikuar me qytetarët në prezencë të njëri tjetrit mbi programe konkrete dhe në takime serioze të regjistruara këto si programe televizive dhe si një formë për të ndjekur në të ardhmen premtimet e bëra publike.

Gjithashtu, në konceptim e tyre ata e shikonin të pakuptimtë daljen publike dhe përballjen njësoj si kandidatët për kryetarë edhe të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë.

Përdorimi i fëmijëve në fushatë

Edhe në këtë fushatë zgjedhore fëmijët janë përdorur si dekor gjatë takimeve elektorale, duke marrë pjesë në to të veshur me bluza me slogane në mbështetje të partive politike apo kandidatëve apo edhe mbajtur në duar pankarta e flamurë. Veçanërisht i dukshëm ka qenë ky fenomen në takimet elektorale të Aleancës për Shqipërinë Europiane, takime në të cilat është vënë re edhe ndërprerja e mësimit dhe nxjerrja e fëmijëve në takime nga mësuesit dhe të shoqëruar nga këta të fundit.

Incidente

Gjatë fushatës nuk kanë munguar incidentet, incidente të cilat janë pasqyruar gjerësisht nga media, ndërkohë që kandidatët dhe partitë politike kanë munguar të distancohen nga incidentet në të cilat janë bërë protagonistë mbështetësit respektivë, duke tentuar përgjithësisht drejt justifikimit të tyre si të provokuara nga kundërshtarët politikë. Prokuroria mungoi të luajë një rol pro aktiv në hetimin dhe zbardhjen e shpejtë të incidenteve të ndodhura, qysh gjatë fushatës së parakohshme zgjedhore.

Gjithashtu, gjatë fushatës nuk kanë munguar edhe pretendimet e shumta për blerje apo tentativa të blerjes së votës, shumë prej të cilave të bëra publike, veçanërisht në mediat sociale, por edhe në ato tradicionale.

Përgjithësisht tentativat për blerje vote janë fokusuar në blerje vote pozitive⁴² nëpërmjet formave si shpërndarje të ndihmave për familjet në nevojë, premtimet për vende pune apo edhe pagesa në forma të tjera.

Vëzhguesit e KVV kanë marrë pretendime të tilla në disa bashki por në asnjë rast nuk janë paraqitur prova të cilat të mundin ta provojnë faktin përtej çdo dyshimi të mundshëm.

E rëndësishme është të theksohet se Prokuroria sërish ka munguar të luajë një rol pro aktiv dhe të vihej në lëvizje kryesisht në asnjë rast, qoftë edhe bazuar në indikacionet e marra nga mediat.

Një tjetër fenomen i vërejtur nga vëzhguesit në disa raste është edhe pengimi i kandidatëve apo subjekteve zgjedhore për të kryer fushatë. Tentativa të tilla janë vëzhguar në Marikaj në datë 11 qershor 2015⁴³ dhe në Vlorë në datë 19 qershor 2015⁴⁴.

⁴² Nxitje e votuesve që të votojnë për një kandidat të caktuar.

⁴³ Persona me makina me flamurë të LSI, kanë tentuar të pengojnë mbështetësit e APPD të marrin pjesë në një takim electoral duke bllokuar sheshin ku do zhvillohej mitingu me makina, duke e përdorur si parking. Policia nuk ka ndërhyrë.

⁴⁴ Në 18 Qershor ishin parashikuar për t'u zhvilluar paralelisht dy mitingje elektorale në Vlorë, i Partisë për Drejtësi, Integritet dhe Unitet dhe i kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, Vasil Bedinaj në dy sheshe shumë pranë. Duke qenë se vendet ishin pranë dhe do të interferonin, mitingu i PDIU nisi në orën 19:00 dhe në 21:00 i kandidatit Bedinaj. Mitingu i PDIU nuk kishte përfunduar ende në orën 21:00 dhe Bedinaj tentoi të fillonte mitingun, sipas parashikimit, por policia e ndaloi. Në orën 21:30 Bedinaj e nisi mitingun pasi PDIU mbaroi, megjithatë, pavarësisht se mitingu kishte përfunduar në sheshin pranë vazhdoi të mbahej muzikë e lartë duke penguar mitingun e kandidatit Bedinaj të zhvillohej normalisht.

Përdorimi i burime publike në fushatë

Më 4 maj 2015 Kryeministri nxori Urdhrin nr. 67 “Për marrjen e masave për zbatimin e ndalimit të vënies në përdorim të subjekteve zgjedhore të mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, pronë publike, për Zgjedhjet e Organeve të Pushtetit Vendor të datës 21 Qershor 2015, një iniciativë e cila u përgëzua nga KVV si një hap pozitiv.

Por pavarësisht kësaj janë vënë re raste të shfrytëzimit të administratës në fushatë, edhe gjatë orarit të punës⁴⁵, dhe me pjesëmarrjen e ministrave apo zyrtarëve të tjerë të lartë të shtetit, në nivel qendror e lokal⁴⁶. Përdorimi i administratës gjatë takimeve elektorale, shpesh edhe gjatë orarit zyrtar të punës është një tjetër fenomen i vërejtur gjatë fushatës zgjedhore⁴⁷.

Gjithashtu, një tjetër shqetësim është janë rastet e investimeve gjatë fushatës elektorale⁴⁸ të cilat përdoren hapur për të ndikuar dhe orientuar votën e qytetarëve. Inagurime të tilla janë shfrytëzuar gjatë kësaj periudhe në ndihmë të fushatës së kandidatëve të ASHE në shumë raste.

Premtimet elektorale

Në premtimet e bëra gjatë fushatës zgjedhore nga kandidatët kanë mbizotëruar ato që lidhen me investime infrastrukturore në bashkitë përkatëse, apo me tentativa për rritjen e mirëqenies dhe punësimit.

Ajo çka mund të vihet në dukje është se premtimet nuk kanë qenë të bazuara në plane apo hapa konkretë e të matshëm, por kanë mbetur në rangun e përgjithshëm e propagandistikë çka e bën të vështirë gjykimin mbi realizueshmërinë e tyre.

Me zgjerimin e bashkive të reja, një problem që mund të lindë është integrimi i politikave për zonat rurale me ato urbane.

Kandidatët kanë dështuar të detajojnë plane konkrete për harmonizimin e këtyre zonave me karakteristika të ndryshme, duke premtuar veçmas për zonat rurale e veçmas për ato

⁴⁵ Gazeta Panorama, 3 Qershor 2015. PD: *Akuza Nikollës, Mbylli shkollat në Sarandë për t’I çuar nxënësit në mitingun e Koço Kokëdhimës.*

⁴⁶ Një rast që meriton vëmendje të veçantë në këtë drejtim është artikulli i shkruar nga drejtori i Agjensisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Andi Kananaj, “Një replikë me kritikët e Erionit të Mjaftit”“, botuar në gazetën Dita vetëm tri ditë pas nisjes së fushatës zgjedhore, më 25 Maj. Pavarësisht se artikulli le të kuptohet se është në mbrojtje të një ish drejtuesi të shoqërisë civile dhe jo i lidhur me fushatën zgjedhore, në fakt Kananaj haptas mbështet kandidaturën e Veliaj për Bashkinë Tiranë në të, duke qenë se përmend kandidatin e APPD, Halim Kosova dhe krahason aftësitë e dy kandidatëve, deri duke e mbyllur artikullin me bindjen e nënkuptuar se Veliaj do të jetë fitues. Ky artikull meriton vëmendje të veçantë duke qenë se Kananaj, përtej të qenit thjesht një zyrtar i shtetit shqiptar, është në një pozicion shumë delikat duke qenë drejtues i të vetmes agjensi qeveritare që mbështet me fonde shoqërinë civile dhe mbështetja e hapur e tij, në nivele deri militantizmi, ndaj një kandidati lë shteg për shumë keqkuptime mbi mesazhin që organizatat e shoqërisë civile mund të marrin, veçanërisht në klimën ku pavarësia e organizatave të shoqërisë civile është e rrezikuar nga politizimi i tejskajshëm i çdo aspekti të skenës publike. Për më shumë shih artikullin në: <http://www.gazetadita.al/nje-replike-me-kritiket-e-erionit-te-mjaft-it/>.

⁴⁷ Sipas vëzhguesve në të KVV në KZAZ, në një numër të konsiderueshëm rastesh janë vërejtur nëpunës publikë në takime me kandidatët gjatë orarit zyrtar të punës. Biles kryetari i KZAZ nr. 81 pretendon se shtabi elektorale i Partisë Socialiste i kryen takimet në ambintet e Bashkisë Orikum.

⁴⁸ Bashkia Bulqizë ka nisur rikonstruksionin e rrugës pedonale dhe të unazës së poshtme të Qytetit të Vjetër në datë 25 Maj 2015. http://www.ekspres.al/index.php?option=com_content&view=article&id=28106:2015-06-12-10-24-08&catid=112:lajme-kryes.

urbane, pra duke i trajtuar bashkitë e reja si njësi administrative të lidhura mes tyre vetëm nga një administrator i përbashkët e jo si njësi unike administrative.

Në vazhden e nisur gjatë fushatës së hershme zgjedhore, edhe gjatë fushatës zyrtare ka vazhduar trendi i premtimeve jo-realiste dhe të palidhura me kompetencat e pushtetit vendor⁴⁹, apo argumenti i përdorur shpesh nga kandidatët e Aleancës për Shqipërinë Europiane se duke qenë se kjo Aleancë është aktualisht në maxhorancë dhe qeverisje, votimi i kandidatëve të Aleancës Popullore për Punë dhe Dinjitet do të sillte rrudhje të investimeve për bashkitë përkatëse.

Ky mesazh përbën një shkelje të rregullave të barazisë dhe një kërcënim ndaj zgjedhësve për ndëshkim në rast të votimit kundër kandidatëve të mbështetur nga maxhoranca qeverisëse.

Pasqyrimi i fushatës zgjedhore nga media

Media e ka transmetuar gjerësisht fushatën zgjedhore duke vazhduar transmetimin e takimeve elektorale me sinjal, kaseta dhe tekst të prodhuar nga shtabet elektorale të partive politike.

Fushata është pasqyruar gjerësisht edhe në mediat sociale, qoftë nëpërmjet faqeve të menaxhuara nga vetë partitë apo kandidatët në garë, qoftë nga faqet zyrtare në to të mediave. Një fenomen për t'u vërejtuar kanë qenë rastet e mediave që kanë sponsorizuar artikuj të tyre në rrjetin social Facebook, në mënyrë që artikuj të caktuar, të cilët specifikisht u referohen kandidatëve konkretë, të shfaqen në faqen kryesore (Neësfed) të audiencës. Pavarësisht se ky veprim nuk është i jashtëligjshëm, ngrihen dyshime mbi motivet dhe personat që kanë paguar për këtë reklamë dhe nëse këto mund t'i faturohen ndonjë subjekti politik konkurrent si fushatë⁵⁰.

C. MEDIA

Bordi i Monitorimit të Medias (BMM)

Bordi i Monitorimit të Mediave (BMM) është një prej aktorëve kyç në monitorimin e mënyrës së pasqyrimin të fushatës zgjedhore duke qenë se “ka për detyrë monitorimin e zbatimit të dispozitave të [...] Kodit për fushatën zgjedhore në radion dhe televizionin publik si dhe në ato private.”⁵¹

KQZ vendosi për ngritjen e BMM-së në mbledhjen e datës 6 Maj 2015, pas një procesi të përzgjedhjes dhe propozimit të anëtarëve të tij në shkelje të afateve ligjore⁵² dhe jo-transparente⁵³.

⁴⁹ Kandidatja e APPD në Durrës, G. Duma, datë 1 qershor: do të punësoj një person nga çdo familje. <http://www.balkanweb.com/site/duma-suksesi-yne-minimalisht-nje-i-punesuar-per-cdo-familje%E2%80%8F/>

⁵⁰ Në datë 3 qershor 2015, faqja zyrtare e javanews.al në Facebook ka sponsorizuar për shfaqjen në Newsfeed të artikullit “Ja historia e Klinikës pa leje të Halim Kosovës”. Është i paqartë motive për sponsorizimin e një artikulli i cili specifikisht i referohet njërit prej kandidatëve në garë për Bashkinë Tiranë gjatë fushatës zgjedhore.

⁵¹ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. (Ligj Nr. 10 019, datë 29.12.2008 [ndryshuar me ligjin nr. 74/2012]. Neni 85, Pika 1.: “KQZ-ja, 40 ditë përpara fillimit të fushatës zgjedhore, ngre Bordin e Monitorimit të Medias, i cili ka për detyrë monitorimin e zbatimit të dispozitave të këtij Kodi për fushatën zgjedhore në radion dhe televizionin publik dhe ato private.”

⁵² Afati i fundit për ngritjen e BMM ishte data 12 prill 2015 bazuar në Kodin Zgjedhor (Ligj Nr. 10 019, datë 29.12.2008 [ndryshuar me ligjin nr. 74/2012], Neni 85 “Monitorimi i fushatës zgjedhore”, pika 1

Gjatë periudhës së funksionimit të tij, deri në datë 18 qershor 2015 ka paraqitur raporte të përditshme mbi pasqyrimin e fushatës zgjedhore nga media⁵⁴ si dhe 3 raporte përmbledhëse (4, 9 dhe 13 qershor).

Për t'u shënuar se anëtarët e BMM në dy raportet e paraqitura në datë 4 dhe 9 qershor 2015, janë paraqitur opinione të ndara të shumicës dhe pakicës në BMM (firmosur respektivisht nga katër dhe tre anëtarë).

Raportet binin dakord përse i përket minutazhit të raportuar për televizionet e mbuluara, por kishite ndryshim në opinione në lidhje me masat që duhet të merreshin nga KQZ ndaj televizioneve jo-publike.

Sipas raportit të shumicës, televizionet jo-publike që kishin kaluar minutazhin në favor të forcave politike do të duhet të ndëshkoheshin me gjobë, ndërkohë që në raportin e pakicës opinioni i shprehur ishte se duke qenë se Kodi Zgjedhor nuk e përcakton se brenda cilës periudhë duhet të balancohen minutazhet, por vetëm citohet se minutazhi duhet të jetë i balancuar nuk mund të justifikohet gjoba por propozohet që këto operatorë të kenë mundësinë të kompensojnë kohën e transmetimit.

Në rastet e dy raporteve të para KQZ vendosi që të mos penalizonte asnjë operator dhe se TVSH bashkë me operatorë televizivë jo-publikë do të duhej të kompensojnë kohën që kishin transmetuar në favor të njërit subjekt politik me kohë për subjektet kundërshtarë.

Në raportin e datës 15 qershor u propozuan unanimisht nga anëtarët e BMM masa me gjobë për dy televizione lokale, ndërkohë që BMM konstatoi se TV e tjera e kishin përmirësuar ndjeshëm balancën në minutash. KQZ vendosi të penalizonte me gjobë dy operatorë lokalë⁵⁵.

Pasqyrimi i fushatës zgjedhore nga mediat

Mediat e shkruara dhe ato elektronike e kanë pasqyruar gjerësisht fushatën e kandidatëve, vecanërisht atë të dy koalicioneve kryesore.

Ajo që mund të vihet në dukje, siç u paraqit në raportin e BMM të datës 4 qershor 2015, është disbalanca në transmetimin e aktiviteteve të Lëvizjes Socialiste për Integritet, aktivitetet e së cilës nuk kanë qenë në proporcion me të tjera parti që kanë marrë më pak se 20% në zgjedhjet e fundit parlamentare, siç parashikohet nga Kodi Zgjedhor; ndërkohë që PS dhe PD kanë patur më shumë se dyfishin e kohës të mbulimit sesa partitë që kanë marrë deri në 20% të votave nga një pjesë e konsiderueshme e televizioneve⁵⁶.

“KQZ-ja, 40 ditë përpara fillimit të fushatës zgjedhore, ngre Bordin e Monitorimit të Medias, i cili ka për detyrë monitorimin e zbatimit të dispozitave të këtij Kodi për fushatën zgjedhore në radion dhe televizionin publik dhe ato private.”

⁵³ Koalicioni I Vëzhguesve Vendorë, *Raport i Ndërmjetëm Monitorimi II – Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 21 Qershor 2015, Seksioni H. Media*, fq. 49. <http://zgjedhje.al/uploads/File/2014-2015/KVV-RaportiNdermjetemMonitorimi-II-ZgjedhjeLokale2015-4Qershor2015.pdf>.

⁵⁴ Raportet e BMM në faqen zyrtare të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve: <http://www2.cec.org.al/sq-al/Zgjedhjet/Raportet-e-Bordit-t%C3%AB-Monitorimit-t%C3%AB-Mediave>.

⁵⁵ 1,5 milionë lekë gjobë për operatorin Antena Nord “Për prishjen e balancës kohore për transmetimin e fushatës zgjedhore” dhe 2 milionë lekë gjobë për Vlora Channel “për mos zbatimin e vendimit të KQZ-së si dhe ndërprerjen e transmetimit të materialeve denigruese”. <http://www2.cec.org.al/sq-al/Kreu/ID/363/Njoftim-per-shtyp-15062015>.

⁵⁶ Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Raportet e Bordit të Monitorimit të Mediave, *Raport I Bordit të Monitorimit 22.05.2015-04.06.2015*. <http://www2.cec.org.al/sq-al/Zgjedhjet/Raportet-e-Bordit-t%C3%AB-Monitorimit-t%C3%AB-Mediave>.

Transmetimi nga mediat i informacioneve të përgatitura nga partitë politike

Edhe gjatë fushatës zyrtare, njësoj si në fushatat e dy raundeve të fundit zgjedhore, ka vazhduar fenomeni i transmetimit të takimeve elektorale nga televizionet duke përdorur sinjalin e prodhuar nga vetë shtabet elektorale me anë të regjisë qendrore apo kasetat informative të përgatitura po prej tyre me zë dhe figurë dhe që thjesht transmetohen nga media, duke i kthyer këto të fundit thjesht në përçuese të informacionit të përgatitur. KVV nuk ka patur informacion për episode në të cilat mediat të kenë kërkuar të jenë prezent dhe të mos jenë lejuar të filmojnë vetë.

Në Raportin II të Monitorimit, KVV rekomandoi që mediat të angazhoheshin “...që në rast të transmetimit të materialeve të gatshme të ofruara nga shtabet elektorale të kandidatëve apo subjekteve zgjedhore të vendosin një njoftim me titra të dukshme në të cilin publiku të njoftohet se materiali i cili po u ofrohet është një material propagandistik i përgatitur nga stafet elektorale të partive dhe jo nga gazetarët respektivë të medias⁵⁷”. Asnjë nga mediat në vend nuk e mori në konsideratë këtë rekomandim, duke vazhduar të transmetonin materialet e përgatitura nga shtabet elektorale të partive politike apo kandidatëve çka, pavarësisht se nuk është detyrim ligjor, do të ishte një akt etike i mediave dhe respektimi i audiencës.

Gjuha dhe etika në media

Përdorimi i gjuhës fyese, sulmeve personale ndaj kandidatëve apo gjuhës së urrejtjes ndikon negativisht në polarizimin e situatës politike dhe në ndarje fiktive të zgjedhësve bazuar në një mentalitet “ne” kundër “atyre”, mentalitet i cili nuk është i shëndetshëm për asnjë shoqëri e aq më pak për shoqëritë në tranzicion ku pasionet politike mund të krijojnë premisat për konflikte politike.

Gjuha e përdorur nga mediat tradicionale në vend gjatë fushatës zgjedhore ka qenë qenë përgjithësisht e balancuar, me përjashtim të gazetës zyrtare të opozitës, Rilindja Demokratike.

Problematike paraqitet situata e gjuhës së përdorur përse u përket mediave *online* që mundësojnë komentimin nga përdoruesit në artikujt e tyre. Pavarësisht se gjuha e përdorur nga vetë mediumi mund të jetë neutrale, shpesh vërehet përdorimi i epiteve fyese e denigruese nga komentuesit.

Një pjesë e konsiderueshme e mediave të cilat mundësojnë këtë shërbim, vendosin për përdoruesit një paralajmërim në të cilin u kërkojnë atyre të mos përdorin gjuhë fyese apo sulme personale, por jo rrallë komentet sërish shkojnë në drejtim fyese.

Ndërkohë administratorët e faqeve shpesh nuk marrin masa për fshirjen e komenteve apo bllokimin e përdoruesve të cilët bëjnë të tilla komente ose reagojnë me vonësë.

Rasti i kandidatit për kryetar bashkie të Aleancës për Shqipërinë Europiane në Elbasan – Qazim Sejdi

⁵⁷ Koalicioni I Vëzhguesve Vendorë. *Raportin II Monitorimit – Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 21 Qershor 2015*, fq. 66. <http://zgjedhje.al/uploads/File/2014-2015/KVV-RaportiNdermjetemMonitorimi-II-ZgjedhjeLokale2015-4Qershor2015.pdf>.

Në 16 Qershor 2015 në disa media u shfaq një video në të cilën kandidati për kryetar bashkie i ASHE për Bashkinë Elbasan, Qazim Sejдини aludoi për ndikimin e tij për largimin nga puna të një gazetari. Gazetarja që e kishte zëvendësuar gazetarin e larguar ishte gjithashtu e rrezikuar për shkak të qendrimeve të saj. Videoja u trajtua gjerësisht në opinione e shkrime.

Vetë Z. Sejдини bëri një deklaratë publike në të cilën pohonte se video ishte një bisedë jo formale mes tij dhe gazetarëve e një viti më parë dhe se nuk kishte për qëllim të kërcënonte askënd.

Pavarësisht se në një rast të tillë, video nuk është e lidhur drejtpërdrejt me fushatën zgjedhore, aluzionet e bëra në video në lidhje me fuqinë e kandidatit për të larguar gazetarët kritikë nga puna dhe çfarë është më e keqja, në lidhje me fuqinë e pushtetit politik për të mbyllur televizionet nëse pronarët e mediave dëmtojnë interesat e tij dhe se pronarët e mediave janë të lidhur pazgjidhshmërisht me këtë pushtet janë jashtëzakonisht shqetësuese.

Këto deklarata hapur ilustrojnë një nga problemet më të mprehta për lirinë e medias në Shqipëri, lidhjen e tyre me interesa politike dhe paaftësinë, si rrjedhim, për të mbajtur qëndrime kritike serioze ndaj pushtetit.

D. PJESËMARRJA E GRAVE

KVV e konsideron si një arritje shumë të rëndësishme për barazinë gjinore dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë ndryshimin ligjor që parashikon vendosjen e kuotës gjinore në 50% të listave për candidate për këshillat bashkiakë dhe ka vlerësuar faktin që partitë politike arritën, pavarësisht kohës së shkurtër në dispozicion, të plotësonin listat shumëemërore me emra nga secila gjini sipas kërkesave të amendimeve të Kodit Zgjedhor.

Për sa i përket numrit të kandidatëve për kryetare të bashkive gratë vazhdojnë të mbeten në pakicë të theksuar, nga kandidatët e regjistruar në KQZ dhe KZAZ për kryetarë bashkie ka vetëm 16 gra candidate nga 162 kandidatë në total⁵⁸. Për sa i përket numrit të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë rezultoi se nga 36.251 kandidatë për anëtarë të këshillave bashkiakë 17.887 janë gra (pra 49,34%) dhe 18.364 janë burra (pra 50,66%).

Kodi Zgjedhor parashikon kuota gjinore edhe në anëtarësinë e KZAZ-ve të propozuar nga dy partitë politike më të mëdha të shumicës dhe opozitës [respektivisht Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD)], të cilat kanë detyrimin që në tërësinë e propozimeve të tyre 30 % të jenë nga secila gjini. Kuota gjinore prej 30% u respektua në momentin e konstituimit të KZAZ-ve dhe u ruajt në vazhdim, edhe pas zëvendësimeve të shumta të anëtarëve të KZAZ-ve.

⁵⁸ Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASHE) ka kandiduar 12 gra nga 59 kandidatë në total (Bashkia Klos, Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Gramsh, Bashkia Mat, Bashkia Patos, Bashkia Roskovec, Bashkia Libohovë, Bashkia Pogradec, Bashkia Shkodër, Bashkia Përrenjas, Bashkia Sarandë dhe Bashkia Ura Vajgurore). Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet (APPD) ka kandiduar 3 gra nga 61 kandidatë në total (Bashkia Durrës, Bashkia Himarë dhe Bashkia Shkodër).

Ndërkohë vetëm është regjistruar vetëm 1 candidate e propozuar nga zgjedhësit, e cila kandidon për Bashkinë Selenicë, Qarku Vlorë.

Pavarësisht arritjeve ligjore dhe ruajtjes së kuotave gjinore në KZAZ, ajo që u vu re është se gjatë fushatës gratë kandidatë për këshillat bashkiakë nuk luajtën ndonjë rol. Fenomeni nuk është i shkëputur megjithatë, pasi në përgjithësi kandidatët kanë qenë të padukshëm gjatë fushatës në përgjithësi duke qenë se fushata zgjedhore u fokusua vetëm në kandidatët për kryetarë bashkie.

Në anën pozitive, mund të thuhet se, bazuar në raportimet e vëzhguesve të KVV në të gjithë vendin, në përgjithësi ka patur një rritje të pjesëmarrjes së grave në takime elektorale, në krahasim me zgjedhjet e fundit, pavarësisht se shifrat ekzakte janë të vështira për t'u vlerësuar.

Premtimet për politika lokale me bazë gjinore nuk kanë qenë në fokus të fushatës zgjedhore të kandidatëve, duke qenë se premtimet kanë qenë në shumicën e rasteve të përgjithshme dhe të bazuara kryesisht në investime infrastrukturore. Megjithatë, në disa raste janë vërejtur premtime e angazhime konkrete të kandidatëve në lidhje me barazinë gjinore, veçanërisht në takime me organizata të shoqërisë civile gjatë të cilave janë pyetur specifikisht në lidhje me këtë çështje.

E. E DREJTA PËR INFORMIM DHE VËZHGESIT

Transparenca e veprimtarisë dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve është një nga parimet bazike të një demokracie të konsoliduar e funksionale. Një nivel i lartë transparence krijon premisat për rritjen e besimit të qytetarëve tek institucionet, çka shkon krahas krahas me cilësinë e demokracisë së një vendi.

Nën këtë optikë, akoma më e rëndësishme është transparenca për vendet me demokraci të brishtë, si Shqipëria, ku niveli i besimit të qytetarëve ndaj institucioneve është shumë i ulët, duke qenë se besimi dhe niveli i demokracisë janë të lidhur ngushtë.

Në këtë frymë dhe në përmbushje të kriterëve që Shqipëria duhet të përmbushë për anëtarësimin në BE, në Shqipëri janë ndërmarrë nisma të shumta me synim rritjen e transparencës, ndër të cilat mund të përmenden miratimi, në Shtator të vitit të shkuar, i Ligjit për të Drejtën e Informimit⁵⁹ si dhe adoptimin nga Kuvendi i Shqipërisë, në dhjetor të vitit të shkuar, të Rezolutës “Për njohjen dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile në procesin e zhvillimeve demokratike të vendit civil”⁶⁰.

Një rëndësi primare merr transparenca e procesit zgjedhor, duke qenë zgjedhjet e lira dhe të ndershme themeli i demokracisë.

Qytetarët duhet të kenë të gjithë aksesin në informacion në lidhje me këtë proces, në mënyrë që besimi i publikut ndaj tij dhe, si rrjedhim, në institucionet që ky proces do të prodhojë, të rritet.

Gjatë procesit përgatitor që u ka paraprirë Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore 2015 transparenca e institucioneve të lidhura me procesin, veçanërisht ajo e Komisionit

⁵⁹ Kuvendi i Shqipërisë, Ligji nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”. http://www.parlament.al/web/pub/ligj_nr_119_dt_18_9_2014_19327_1.pdf.

⁶⁰ Kuvendi i Shqipërisë, Rezolutë për njohjen dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile në procesin e zhvillimeve demokratike të vendit, Miratuar më 24.12.2014. http://www.parlament.al/web/pub/rezoluta_per_shoqerine_civile_dt_24_12_2014_20560_1.pdf

Qendror të Zgjedhjeve, ka lënë për të dëshiruar, pavarësisht se në momente të caktuara gjatë procesit ka patur përmirësim në këtë drejtim.

Pavarësisht se mbledhjet e KQZ janë publike dhe transmetohen në kohë reale në faqen web të tij, ndjekja e mbledhjeve është e vështirë dhe, në shumë raste krejt e pavlerë nëse vëzhguesit nuk kanë në dorë të gjithë informacionin paraprak mbi të cilin komisionerët, administrata dhe përfaqësuesit e partive politike diskutojnë.

Kjo pasi shpesh diskutimet bëhen të paplota dhe u referohen dokumenteve të shkruara, mungesa e të cilave e bën të pamundur të kuptuarin e çështjes që po diskutohet.

KVV ka konstatuar vazhdimisht se KQZ është treguar e ngurtë ndaj kërkesave të vëzhguesve të saj, duke mos ofruar informacionin e kërkuar ose duke e ofruar atë të mangët⁶¹.

Edhe në periudhën e mbuluar nga ky raport ky shqetësim ka vazhduar, bile prej datës 15 qershor është bërë akoma më i mprehtë pasi administrata e KQZ ka marrë një urdhër që materialet paraprake të mbledhjeve t'u shpërndahen vetëm vëzhguesve të partive politike dhe atyre të OSBE/ODIHR⁶², duke e kufizuar ndjeshëm efikasitetin e vëzhgimit të mbledhjeve të KQZ-së.

Akoma më problematike bëhet kjo situatë duke qenë se materialet paraprake të mbledhjeve jo gjithnjë janë në faqen zyrtare të KQZ-së dhe shpesh shumë materiale mungojnë. Në këto kushte, transparenca e institucionit të KQZ është në nivele shumë të ulëta, KQZ ka një qëndrim deri hermetik ndaj vëzhguesve të KVV.

Në këtë frymë, në mbledhjen e datës 10 qershor 2015, gjatë diskutimeve për caktimin e vendndodhjes së QV-ve, Kryetarja e KQZ, znj. Luzi iu drejtua vëzhguesit të KVV duke i kërkuar të mos vazhdojë të shkruajë pasi çdo diskutim, qoftë me ose pa mikrofon, do t'i ofrohej nëpërmjet procesverbalit të mbledhjes.

Reagimi i Kryetares së KQZ ndaj vëzhguesit, vetëm pak ditë pasi ishte publikuar Raporti II i Monitorimit të KVV⁶³, ku ndër të tjera përmendej si problematik komunikimi pa mikrofon i anëtarëve gjatë mbledhjeve zyrtare të KQZ, që vështirëson vëzhgimin, është i pakuptimtë dhe toni jo etik i përdorur ndaj vëzhguesit jashtë kornizës së marrëdhënies insitucionale që KQZ duhet të mbajë ndaj vëzhguesve të procesit zgjedhor.

Urdhri për mosshpërndarjen e materialeve paraprake për vëzhguesit, përveçse për ata të OSBE/ODIHR menjëherë pas këtij episodi e bën akoma më problematike këtë situatë dhe e konsolidon qëndrimin e ngurtë dhe jo bashkëpunues të KQZ-së ndaj vëzhguesve të KVV.

⁶¹ Referoju Raportit I dhe II të Ndërmjetëm të Monitorimit për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 21 Qershorit 2015 për më shumë mbi këtë. www.zgjedhje.al.

⁶² Urdhri iu është komunikuar verbalisht vëzhguesve të KVV në KQZ, nuk ka informacion nëse urdhri është verbal apo i shkruar.

⁶³ Raporti II i Monitorimit për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 21 Qershorit 2015 nga KVV u publikua më 4 Qershor 2015. <http://zgjedhje.al/uploads/File/2014-2015/KVV-RaportiNdermjetemMonitorimi-II-ZgjedhjeLokale2015-4Qershor2015.pdf>.

Në fillim të muajit maj, gjatë një takimi me Grupin Ndërkombëtar të Punës për Zgjedhjet të organizuar dhe koordinuar nga OSBE, Kryetarja e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, përfaqësues të KQZ dorëzuan për vëzhguesit ndërkombëtarë një dokument në të cilin shqyrtonin disa nga pikat e Raportit I të Ndërmjetëm të KVV-së për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2015, publikuar më 30 mars 2015.

KVV e vlerëson si shumë pozitiv faktin që KQZ ka vendosur të marrë seriozisht raportimet e vëzhguesve vendorë, raporte sistematikisht të injoruara nga institucionet shqiptare që merren me administrimin e zgjedhjeve dhe është e gatshme të vlerësojë çdo koment apo kritikë të KQZ ndaj punës së tij.

Megjithatë, KQZ asnjëherë nuk i dërgoi KVV-së një kopje të komenteve të veta në lidhje me raportin e sipërpërmendur, megjithë premtimin e bërë nga vetë Kryetarja në takimin zyrtar të zhvillura disa ditë më pas, duke krijuar një situatë absurde, në të cilën vendos në dijeni përfaqësues të institucioneve të huaja e përfaqësive diplomatike në vend mbi një dokument të shkruar nga një aktor vendas dhe duke mos komunikuar me këtë aktor drejtpërdrejt në asnjë moment.

Mungesa e informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Në datë 28 Maj 2015, KVV i dërgoi Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Z. Artur Zoto, dhe për dijeni Ministrit të Brendshëm, atij të Drejtësisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile një letër zyrtare⁶⁴ në të cilën i kërkohej informacion në lidhje me votuesit në IEVP-të e vendit dhe konkretisht:

Numrin e të gjithë personave që janë duke vuajtur dënimin në të gjitha IEVP-të të cilët marrin të drejtën e votës deri në datë 21 Qershor;

numrin e personave që u është hequr kjo e drejtë me vendim gjykatë;

si dhe listën e Qendrave të Posacme të Votimit që do të ngrihen pranë IEVP-ve në të gjithë vendin si dhe numrin e votuesve në secilën prej tyre;

nëse ka IEVP për të cilat plotësohen kriteret ligjore për ngritjen e QV-ve por në të cilat nuk do të ngrihen të tilla;

cilat janë masat e marra për garantimin e të drejtës së votës për personat që vuajnë dënimin në IEVP në të cilat nuk do të ngrihen QV si dhe kopje të dokumentacionit në lidhje me informacionin e kërkuar më sipër.

Pavarësisht se ligji për të Drejtën e Informimit parashikon në Nenin 15 të tij⁶⁵ se përgjigja Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të kishte kthyer një përgjigje në lidhje me këto çështje deri në datë 11 Qershor 2015, deri në datën 18 Qershor, asnjë përgjigje zyrtare nuk ka ardhur nga ky institucion, në shkelje të hapur të ligjit.

Në datën 11 Qershor 2015, Ministria e Drejtësisë i ka dërguar një letër Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe për dijeni KVV në të cilën Ministria i kërkon kësaj Drejtorie të mundësojë informacionin për KVV por edhe pas kësaj letrë asnjë reagim nuk pati nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

⁶⁴ Shkresë drejtuar Drejtorisë Përgjithshme të Burgjeve, Z. Artur Zoto.

Për dijeni: Ministrit të Drejtësisë z. Nasip Naço, Ministrit të Brendshëm z. Saimir Tahiri, Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, z. Bledar Doracaj. Nr. 0529/1B Prot., datë 28/05/2015.

⁶⁵ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletorja Zyrtare nr. 160, viti 2014*. Ligj nr. 119/2014 Për të Drejtën e Informimit. Neni 15 “Afati për marrjen e informacionit”, pika 1. “Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe”.

Vëzhguesit e akredituar për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të 21 Qershorit 2015

Deri në datën 17 Qershor 2015, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka akredituar 2673 vëzhgues vendas dhe të huaj, afatgjatë dhe afatshkurtër, për vëzhgimin e Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të 21 Qershorit.

Nga këta, 289 janë vëzhgues të akredituar nga organizata ndërkombëtare, 137 janë afatgjatë dhe 152 afatshkurtër; 2212 janë vëzhgues të akredituar nga organizata vendore, 535 afatgjatë dhe 1677 afatshkurtër; 53 janë akredituar nga përfaqësitë diplomatike në Shqipëri dhe 119 janë përfaqësues të mediave.

III. REKOMANDIME

Për partitë politike

Të mos lejojnë që konfliktualiteti politik të afektojë cilësinë dhe integritetin e ditës së zgjedhjeve.

Të marrin të gjitha masat që mbështetësit politikë që do të angazhohen si komisionerë ditën e zgjedhjeve të kenë një qëndrim sa më profesional e të paanashëm, larg konfliktualitetit dhe mbi interesat e ngushta partiake.

Të angazhohen si komisionerë njerëz me integritet të lartë moral që do të vendosin cilësinë e procesit mbi interesat partiake.

Të angazhohen të mos ndërrojnë anëtarët e KZAZ-ve dhe të KQV-ve që tanimë janë trajnuar në mënyrë që procesi të jetë sa më profesional.

Për median

Të mbulojnë ditën e zgjedhjeve me paanshmëri e profesionalizëm, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çdo sinjali për blerje votash, parregullsi të procesit apo të tjera problematika dhe të vendosin integritetin e procesit dhe interesin e qytetarëve shqiptarë përpara interesave të linjave editoriale të medias përkatëse.

Për zyrtarët e lartë

Të qëndrojnë larg qendrave të votimit ditën e zgjedhjeve, duke u dhënë mundësinë qytetarëve që të zgjedhin lirisht dhe larg çdo indikacioni për presion nga politika.

Për KZAZ-të

Anëtarët e KZAZ-ve të respektojnë orarin zyrtar, procedurat dhe ceremonialitetin e mbledhjeve të KZAZ-ve si dhe të veprojnë vetëm duke u bazuar në ligj dhe jo sipas interesave apo porosive të partive politike kur ato janë në kundërshtim me ligjin dhe çënojnë ndërshmërinë e procesit zgjedhor.

Për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve dhe Kolegjin Zgjedhor

Të vazhdojë të ushtrojë autoritetin e tij të plotë në zbatim të detyrimit të ligjit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Kolegji Zgjedhor të qendrojnë brenda kufijve të tagreve që parashikon Kodi Zgjedhor në vendimmarrjet në vazhdim të procesit zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Kolegji Zgjedhor të jenë koherent në vendimmarrjen e tyre në vazhdim të procesit zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të tregojë kujdes më të shumtë në administrimin e procesit zgjedhor në vazhdim.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të marrë masa për të siguruar votimin e qetë të personave që vuajnë heqjen e lirisë, larg presioneve politike.

Për Prokurorinë

Prokurori i Përgjithshëm të nxisë dhe udhëzojë prokurorët, që të vlerësojnë me seriozitetin maksimal çdo shfaqje të veprave penale gjatë procesit të votimit dhe të numërimit.

Prokuroria të hetojë parregullsitë në listat e zgjedhësve dhe të përballë me drejtësinë personat përgjegjës.

Për policinë e shtetit

Të angazhohet totalisht në mbrojtje të shenjtërisë së ditës së votës dhe të ketë një qëndrim të tërhequr ditën e zgjedhjeve.

IV. AKSIONI I KOALICIONIT TË VËZHguesVE VENDORË

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV) është një bashkim vullnetar organizatash jo qeveritare dhe jo politike thelbi i aktivitetit të cilave është mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe zhvillimi i demokracisë në vend, e veçanërisht vëzhgimi i proceseve zgjedhor – aktivitet të cilin që prej vitit 2005 e kanë kryer nën siglën KVV.

Strategjia e veprimit të KVV bazohet në tre shtylla: pavarësi, paanësi dhe objektivitet.

Pas përfundimit të Zgjedhjeve Parlamentare të 23 Qershorit 2013, KVV ka ndjekur nga afër dhe në vazhdimësi situatën politike në vend, në mënyrë të veçantë përgatitjet për Zgjedhjet e ardhshme Lokale të 21 Qershorit 2015 dhe, nëpërmjet prononcimeve publike, shkresave zyrtare apo takimeve të ndryshme, ka shprehur në vazhdimësi shqetësimet e veta lidhur me zhvillimet të cilat potencialisht mund të ndikojnë standardet e këtij procesi.

Pas publikimit të Raportit të Vlerësimit të Situatës Parazgjedhore në 14 Janar 2015, Raportit të Parë të Ndërmjetëm të Monitorimit, i cili mbulonte periudhën prej 10 Janarit në 26 Mars 2015 dhe Raportit të Dytë të Monitorimit që mbulonte periudhën prej 27 Marsit në 21 Maj 2015, në këtë Raport të Tretë mbulohet periudha prej 22 Majit deri në 18 Qershor 2015 (prej fillimit të fushatës zgjedhore deri një ditë para nisjes së heshtjes zgjedhore).

V. FJALORTH

AMA	Autoriteti i Medias Audiovizive
APPD	Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet
ASHE	Aleanca për Shqipërinë Europiane
BMM	Bordi i Monitorimit të Medias
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
GNV	Grup i Numërimit të Votave
IEVP	Institucion i Ekzekutimit të Vendimeve Penale
KÇLAPDNJ	Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
KQV	Komisioni i Qendrës së Votimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë
KZAZ	Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJ. B.	Njësi Bashkiake
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuara
PBDNJ	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
PD	Partia Demokratike
PDIU	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet

PR	Partia Republikane
PS	Partia Socialiste
PSD	Partia Socialdemokrate e Shqipërisë
QV	Qendër Votimi
QVP	Qendër Votimi e Posaçme
RKGJC	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
VNV	Vend i Numërimit të Votave
ZAZ	Zonë e Administrimit Zgjedhor
ZGJC	Zyrat e Gjendjes Civile

Kontakt:

i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë

Gerta Meta	(Shoqata për Kulturë Demokratike)	mob. 0692469393
Rajmonda Prifti	(Shoqata për Gratë dhe Fëmijët)	mob. 0682152667
Premto Gogo	(KRIK Albania)	mob. 0682039297

<u>Tel/fax:</u>	+ 355 4 2245078;
<u>E-mail:</u>	info@zgjedhje.al
<u>Website:</u>	www.zgjedhje.al